



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 5/2024 regjistër (JR)
Datë 07.02.2024

Nr. 86 i vendimit
Datë 20.11.2025

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Mimoza Tasi	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 20.11.2025, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 5/2024 (JR), datë 07.02.2024, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Elio Mazreku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 717, datë 23.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet “a”, “ç”, “d”, “dh” dhe “f”, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44 /2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Elio Mazreku (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse, prej të cilave rezultoi si më poshtë.

2.1 Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave¹ (në vijim “ILDKPKI”), në zbatim të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e krijimit të pasurisë*; (iii) *ka mosdeklarime në vite*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2 Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë raportin e Grupit të Punës, në të cilin ka konfirmuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, duke lënë në vlerësim të Komisionit informacionet e raportuara nga institucioni i verifikimit, sipas së cilave ngriheshin dyshime për përfshirje në korrupsion aktiv të subjektit të rivlerësimit, përpara periudhës së rivlerësimit. Komisioni ka kryer një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit, dhe ka arritur në përfundimin se për subjektin e rivlerësimit, z. Elio Mazreku, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës.

2.3 Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënave e dokumenteve që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 05.11.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Elio Mazreku, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

dhe të dhënave nga burime arkivore të KLP-së, i ka përcjellë Komisionit një raport² të hollësishëm dhe të arsyetuar, për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Elio Mazreku.

3. Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit, duke marrë vendimin nr. 717, datë 23.11.2023.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, pasi kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për të tria kriteret, me vendimin nr. 717, datë 23.11.2023, vendosi: *“Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Elio Mazreku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”*, bazuar në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë.

4.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: *“Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje, lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë, duke u vendosur në kushtet parashikuara sipas leximit a contrario të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e këtij ligji, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra në përputhje me pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016”*.

4.2 Për kriterin e kontrollit të figurës: *“ [...] për subjektin e rivlerësimit, z. Elio Mazreku, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës”*.

4.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *“Subjekti i rivlerësimit arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të shkronjës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016”*.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, më datë 25.01.2024, ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 717, datë 23.11.2023, të Komisionit, duke kërkuar që Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit në seancë gjyqësore publike, si dhe të ndryshojë vendimin e Komisionit, duke vendosur konfirmimin e tij në detyrë.

5.1. Në aspektin procedural, subjekti ka pretenduar se ankimi i tij duhet të analizohet nën dritën e parimit të proporcionalitetit, duke u fokusuar në pasuritë të cilat janë aktualisht në pronësi të tij, si dhe duke mbajtur në konsideratë se pasaktësitë dhe harresat nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi këto pasaktësi nuk janë shoqëruar me përpjekje për fshehje pasurie.

5.2. Ndërsa, sa i takon themelit të çështjes, pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, konkretisht me burimet e krijimit të pasurisë së llojit

² Raport për analizimin e aftësive profesionale, me nr. {***} prot., datë 09.03.2023.

apartament, me sipërfaqe 129.1 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë, e blerë në datën 30.06.2010, në vlerën 15.990.000 lekë, sikurse paraqiten në vijim.

5.2.1. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar që në analizën financiare e kryer nga Komisioni, të konsiderohen të ligjshme të ardhurat që kanë shërbyer për furnizimin e depozitave të cilat kanë qenë burimi për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2010, dhe për krijimin e kursimeve *cash*, konkretisht:

- (a) të ardhurat e subjektit dhe bashkëshortes në organizata/fondacione të ndryshme;
- (b) të ardhurat në shumën 22.000 euro, të dhuruara nga vëllai D. (M.) P.;
- (c) të ardhurat në shumën 5.000.000 lekë, nga trashëgimia/dhurimi nga babai H. M..

5.3. Subjekti ka ngritur pretendime edhe në lidhje me gjendjen e deklaruar *cash*, duke kërkuar të merret në konsideratë deklarata e pasurisë *vetting*, pasi deklaratimet periodike mund të kenë pasaktësi, të cilat nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit të tij nga detyra.

5.4. Po ashtu, subjekti ka ngritur pretendime lidhur me cilësimin si person i lidhur, të vëllait D. P., në kuadër të konkluzionit të Komisionit për mosdeklarimin e pjesëve takuese në pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi, në deklaratën *vetting*, në kundërshtim me përcaktimin në nenin 33, pika 5, shkronjë “a”, të ligjit nr. 84/2016, dhe mungesës së burimeve të ligjshme sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b”, të po këtij ligji, për pasuritë e krijuara prej tij.

5.5. Në datën 04.11.2025, subjekti i rivlerësimit paraqiti nëpërmjet *email-it*, parashtrime mbi shkaqet e ngritura në ankim, duke pretenduar se: (i) informacioni i përcjellë nga ISSh-ja si dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, lidhur me të ardhurat e bashkëshortes, nuk është i plotë, pasi ai disponon dokumente që vërtetojnë se znj. V. M. ka paguar kontributet për sigurimet shoqërore për periudhën dhjetor 2001 – shtator 2002, si dhe vërtetim e raport për periudhat dhe përfitimin e të ardhurës së barrëlindjes; (ii) të ardhurat në shumën 22.000 euro të dhuruara nga vëllai i subjektit D. (M.) P., rrjedhin nga burime të ligjshme, e konkretisht nga vetëpunësimi i tij në Kinë, çka vërtetohet edhe nga zhdoganimi i kontejnerit të sjellë prej tij në vitin 2018; (iii) lidhur me të ardhurat e përfituara nga babai në vitin 2008, subjekti ka pretenduar se, ndonëse institucionet përkatëse nuk dispononin dokumente mbi pagesën e detyrimeve tatimore, faturat e shitjes së materialeve dhe numrat e telefonit të pasqyruara në to, sipas subjektit, vërtetojnë se babai i tij ka ushtruar aktivitet tregtar. Po ashtu, subjekti ka pretenduar se babai i tij nuk duhet të konsiderohet person i lidhur në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Në mbështetje të pretendimeve të tij, bashkëlidhur parashtrimeve subjekti ka paraqitur dokumentet si vijon:

(i) vërtetim mbi bazën e vlerësueshme për të ardhurat e znj. V. M., për periudhën mars 1996 – dhjetor 1999, si dhe për periudhën 2010 – 2011;

(ii) raport barrëlindje për vitin 2005;

(iii) mandatpagesë lëshuar nga ndërmarrja “{***}” me nr. {***}, datë 26.12.2001, pagesë në vlerën 9.516 lekë;

(iv) mandat arkëtimi nr. {***}, datë 26.11.2001, lëshuar nga subjekti “{***}”, me përshkrimin: “Arkëtuar nga V. M. shuma 5508 lekë - siguracion datë 30.10.2001”;

(v) vërtetim barrëlidnje, datë 31.01.2005;

(vi) vërtetim pagesë kontributesh, datë 31.01.2005, për periudhën 01.12.2004 – 31.12.2004;

(vii) kopje të kërkesave për informacion të datës 28.07.2025, drejtuar bankave lidhur me të ardhurat e të ndjerit H. M., si dhe përgjigjet përkatëse³.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Elio Mazreku, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

7. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

8. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 717, datë 23.11.2023, të Komisionit, për shkak të ankimit të subjektit të rivlerësimit Elio Mazreku, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.
9. Trupi gjykues, fillimisht, mori në analizë shkaqet e ankimit me natyrë procedurale, për të vlerësuar nëse ishte i nevojshëm debati gjyqësor, për korrigjimin e ndonjë shkeljeje të rëndë procedurale të Komisionit, që do të cenonte procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, apo me qëllim konstatimin e saktë, të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, në kuptim

³ Printim të ekstraktit të llogarisë bankare, të datës 07.11.2025, ku ndër të tjera evidentohet një tërheqje e kryer nga i ndjeri H. M., në shumën 668.876 lekë, email datë 30.07.2025, nga Intesa Sanpaolo Bank; vërtetimi datë 28.10.2025, nga United Bank of Albania; vërtetim datë 30.07.2025, nga First Investment Bank; kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 29.07.2025, nga American Bank of Investments; kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 04.08.2025, nga Raiffeisen Bank; nr. {***} prot., datë 31.07.2025, nga ProCredit Bank; nr. {***} prot., datë 06.08.2025, nga Union Bank; nr. {***} prot., datë 30.07.2025, nga Tirana Bank; nr. {***} prot., datë 01.08.2025, nga Credins Bank; email i datës 13.08.2025, nga OTP Bank.

të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), si vijon.

10. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se ankimi i tij duhej të analizohej nën dritën e parimit të proporcionalitetit, duke u fokusuar në pasuritë të cilat janë aktualisht në pronësi të tij, si dhe duke mbajtur në konsideratë se pasaktësisë dhe harresat nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi këto pasaktësi nuk janë shoqëruar me përpjekje për fshehje pasurie.
11. Në shqyrtim të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit, konstatoi se pasaktësitë në deklaramë, nuk kanë qenë shkak thelbësor i vendimmarrjes së Komisionit, pasi subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me mungesë të konsiderueshme të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera ndër vite, në raport me të ardhurat e ligjshme të deklaruara, të verifikuara e të provuara gjatë procesit të rivlerësimit. Trupi gjykues çmon të theksojë se, edhe në versionin që të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit do të konsideroheshin sipas pretendimeve të subjektit në analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurisë së llojit apartament banimi, i ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë, përsëri mungesa e burimeve financiare të ligjshme rezulton në një vlerë për të cilën nuk mund të aplikohet zbatimi i parimit të proporcionalitetit.
12. Trupi gjykues sjell në vëmendje përcaktimin në nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet për arritjen e një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollit të figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Në rastin konkret, pavarësisht se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm dhe kualifikues për sa u përket dy kritereve të tjera - kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale - duke rezultuar i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës dhe “i aftë” profesionalisht, ky vlerësim mbetet i pavarur dhe nuk afekton faktin se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj dhe në prova.
13. Për sa më sipër, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike me praninë e subjektit të rivlerësimit, kontrollon zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, bazuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve.
14. Kërkesa e subjektit për marrjen, në cilësinë e provës, e akteve të paraqitura bashkëlidhur parashtrimeve të datës 04.11.2025, u analizua nga trupi gjykues në raport me parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin në shkallë të dytë, konkretisht sipas neneve 47 dhe 49, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Nga analizimi i këtyre akteve shkresore, trupi gjykues vëren se:

14.1. Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortes, znj. V. M., subjekti ka paraqitur: *(i) vërtetim mbi bazën e vlerësueshme për periudhën mars 1996 – dhjetor 1999, si dhe për periudhën 2010 – 2011. Subjekti ka përmendur mandate që lidhen me pagesa kontributesh dhe për barrë lindjeje dhe për periudhën kur ka qenë shtatzënë. Bashkëlidhur*

*prapësimeve, rezulton të jenë paraqitur disa mandate, konkretisht: (ii) raport barrë lindje për vitin 2005; (iii) mandatë pagesë lëshuar nga ndërmarrja {***} nr. {***}, datë 26.12.2001, pagesë në vlerën 9.516 lekë; (iv) mandat arkëtimi nr. {***}, datë 26.11.2001, me përshkrimin: “Arkëtuar nga V., 5508 lekë siguracion... 30.10.2001”; (v) vërtetim barrë lindje, datë 31.01.2005; (vi) vërtetim pagesë kontributesh, datë 31.01.2005, për periudhën 01.12.2004 – 31.12.2004.*

14.2. Në kushtet kur nga ana e subjektit nuk është paraqitur ndonjë argument apo arsye mbi pamundësinë e paraqitjes së këtyre akteve në Komision, jo për faj të tij, vlerësohet se ato nuk mund të pranohen në cilësinë e provës në këtë fazë të procesit, në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Për më tepër, sipas nenit 49, pika 2 të ligjit nr. 49/2012, në këtë moment procedural subjekti ka të drejtën të paraqesë vetëm parashtrimet e tij lidhur me ankimin, por jo të depozitohet akte të cilat kërkohen të merren në cilësinë e provës. Pavarësisht mosplotësisimit të këtij kriteri formal, edhe nëse do të merreshin në konsideratë këto prova, fakti që kërkohet të provohet (pra fakti se janë paguar sigurimet për një periudhë të caktuar kohore), ka një ndikim të atillë (të papërfillshëm) që nuk afekton vlerësimin e ligjshmërisë të të ardhurave të bashkëshortes së subjektit. Në këto kushte, marrja e këtyre akteve në cilësinë e provës vlerësohet e panevojshme edhe sipas nenit 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

14.3. Lidhur me të ardhurat e dhuruara nga babai, nga shqyrtimi i përgjigjeve⁴ të dërguara nga bankat, rezultoi se: i) Raiffeisen Bank ShA, ka kërkuar saktësim të kërkesës, Intesa Sanpaolo Bank ShA, e cila nëpërmjet *email*-it të datës 30.07.2025, ka refuzuar kërkesën për informacion të subjektit me arsyetimin se ai nuk legjitimohej në kërkimin e tij, si dhe ii) Banka Kombëtare Tregtare ShA, i ka vënë në dispozicion një printim të ekstraktit të llogarisë bankare, të datës 07.11.2025, ku ndër të tjera evidentohet një tërheqje e kryer nga i ndjeri H. M., në shumën 668.876 lekë.

14.4. Trupi gjykues vlerëson se, pretendimi i subjektit se bankat nuk i kanë mundësuar dhënien e informacionit, është i pabazuar, pasi subjekti, gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk ka parashtruar ndonjë rrethanë që ka pamundësuar kërkimin dhe marrjen e dokumentacionit bankar për të atin, për sa kohë që të paktën dy prej tyre⁵ nuk ia kanë refuzuar dhënien e tij, ndërkohë që përgjigja e Intesa San Paolo Bank ShA ka nënkuptuar që ai duhet të paraqiste dokumentacion ligjor për legjitimimin e tij. Gjithashtu, trupi gjykues vlerësoi se edhe gjatë gjykimit në Kolegj subjekti ka dështuar të provojë se gjendet në kushtet pikës 2, të nenit 32, të ligjit 84/2016, pra që dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri, ose nuk mund të merret në rrugë tjetër.

15. Lidhur me të ardhurat e dhuruara nga vëllai, subjekti ka pretenduar se ka përfituar të ardhura nga vëllai i tij për periudhën 1995 – 2018. Ndërkohë që nga dokumentacioni i paraqitur në

⁴ Vërtetim i datës 28.10.2025, nga United Bank of Albania; vërtetim i datës 30.07.2025, nga First Investment Bank; kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 29.07.2025, nga American Bank of Investments; nr. {***} prot., datë 04.08.2025, nga Raiffeisen Bank; nr. {***} prot., datë 31.07.2025, nga ProCredit Bank; nr. {***} prot., datë 06.08.2025, nga Union Bank; nr. {***} prot., datë 30.07.2025, nga Tirana Bank; nr. {***} prot., datë 01.08.2025, nga Credins Bank; *email-it* datë 13.08.2025, ora 15:26, nga OTP Bank.

⁵ Raiffeisen Bank dhe Banka Kombëtare Tregtare.

mbështetje të këtij pretendimi, vërtetohet pagesa e kontributeve për periudhën duke filluar nga muaji prill i vitit 2019 e në vijim.

16. Pas shqyrtimit të akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit si më sipër referuar, trupi gjykues arrin në përfundimin se marrja e tyre në cilësinë e provës në drejtim të provueshmërisë së disa fakteve, është e parëndësishme, dhe nuk ndikon në marrjen e vendimit, sipas nenit 49, pika 6, shkronjat “b” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016.
17. Në konsideratë të analizës dhe konkluzioneve të mësipërme për shkaqet me natyrë procedurale⁶, si dhe për marrjen në cilësinë e provës të akteve të sjella nga subjekti me parashtrimet⁷, trupi gjykues çmoi se shqyrtimi i kësaj çështje duhet të bëhet në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

*Pasuria e llojit apartament banimi me sipërfaqe 129.1 m², e ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë*

18. Në lidhje me këtë pasuri, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: “*Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar pagesat e kryera në korrik të vitit 2010, për likuidimin e çmimit të pasurisë apartamentit i ndodhur në rrugën {***}, në Tiranë, duke u vendosur në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja ‘b’ e ligjit nr. 84/2016*”.
19. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni, duke pretenduar se pasuria është krijuar nga të ardhurat e ligjshme të tij dhe të bashkëshortes nga punësimi pranë organizatave dhe fondacioneve të huaja, të cilat janë depozituar rregullisht prej saj në llogari bankare, për tu përdorur për likuidimin e çmimit të apartamentit objekt shqyrtimi.
20. Në analizë të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, lidhur me njohjen e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, në raport me konkluzionet e Komisionit lidhur me të, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar për subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues konstaton sa vijon:
21. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar blerjen apartamentit⁸ me sipërfaqe 129.1 m² në rrugën “{***}”, në vlerën 15.990.000 lekë⁹. Si burim krijimi ka deklaruar: “*Depozita e kursimit nr. {***}, në BKT (depozita u mbyll më 02.07.2010); depozita e kursimit nr. {***} te ProCredit Bank (depozita u mbyll më 02.07.2010). Po ashtu, janë tërhequr të holla nga depozita në Bankën Amerikane të Shqipërisë. Për më shumë, referojuni deklaratimit të pasurisë për vitin 2010, si dhe printimeve dhe vërtetimeve bankare bashkëlidhur kësaj deklaratë*”.
22. Në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2010, subjekti ka deklaruar blerjen e apartamentit në vlerën 15.990.000 lekë dhe si burim krijimi ka deklaruar: (i) *Llogaria në*

⁶ Paragrafi 13 më sipër në vendim.

⁷ Paragrafi 16 më sipër në vendim.

⁸ Konfirmuar edhe nga ASHK-ja, në përgjigjen e dërguar pranë Komisionit.

⁹ Ekuivalenti i shumës në valutë, prej 117.000 eurosh.

Intesa Sanpaolo Bank ka pësuar pakësime (për shkak të tërheqjes së shumës 48.000 euro që u përdor për blerjen e apartamentit të përmendur në pikën 3) dhe shtime (për shkak të derdhjes në pagën mujore dhe shpërblimeve të gruas (rreth 7.000 euro). Shuma e deklaruar, 48.000 euro dhe 7.000 euro, pjesa takuese 100%; (ii) Llogaria në ProCredit Bank është tërhequr e tëra dhe nuk ekziston më (shuma u përdor për blerjen e apartamentit të përmendur në pikën 3). Shuma e deklaruar, 24.417 euro, pjesa takuese 100%; (iii) Llogaria në Bankën Kombëtare Tregtare është tërhequr dhe nuk ekziston më që nga 2 korriku 2010 (shuma u përdor për të blerë e apartamentin e lartpërmendur në pikën 1). Shuma e deklaruar, 39.517,50 euro, pjesa takuese 100%.

23. Në datën 30.06.2010, është nënshkruar kontrata¹⁰ e shitblerjes për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 129.1 m², i ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, me një vlerë prej 15.990.000 lekësh. Në kontratë është përcaktuar se çmimi i pasurisë është likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale nga ana e blerësit në favor të shitësit, dhe se shitësi nuk ka asnjë pretendim financiar të mëtejshëm në lidhje me këtë transaksion. Referuar dy mandateve bankare bashkëlidhur kontratës së shitjes rezulton se: (i) Më datë 02.07.2010, subjekti dhe bashkëshortja, kanë tërhequr *cash* nga llogaritë e tyre në Intesa Sanpaolo Bank ShA, Credins Bank ShA dhe Bankën Kombëtare Tregtare ShA, në total shumën prej 111.934 eurosh. Një shumë me vlerë të njëjtë është depozituar prej tyre në *cash*, po atë ditë në llogarinë e z. F. V. (shitësit të pasurisë), në Credins Bank, me përshkrimin: “*Elio Mazreku për blerje apartamenti, kontratë me nr. {***} rep., nr. {***} kol.*”. (ii) Më datë 05.07.2010, bashkëshortja e subjektit ka depozituar *cash* në të njëjtën llogari të z. F. V., shumën 5.000 euro, me përshkrimin: “*Blerje apartamenti, kontratë me nr. {***} rep., nr. {***} kol.*”.
24. Referuar certifikatës për vërtetim pronësie nr. {***}, lëshuar në datën 08.07.2010, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, pasuria objekt vlerësimi figuron e regjistruar në regjistrat hipotekorë në bashkëpronësi të subjektit dhe bashkëshortes së tij.
25. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar¹¹, pjesë e dosjes së administruar, rezulton se në datën 02.07.2010, është kryer depozitimi në shumën 112.000 euro në Credins Bank, për blerjen e apartamentit, shumë e cila korrespondon me tërheqjet *cash* të kryera po atë ditë nga subjekti dhe personi i lidhur në llogaritë e tyre bankare, kronologjia e krijimit të së cilave është trajtuar në paragrafët vijues. Gjithashtu, rezulton një depozitim i dytë nga bashkëshortja e subjektit në shumën 5.000 euro, i cili, së bashku me shumën e parë, ka shërbyer për plotësimin e çmimit të apartamentit në vlerën 117.000 euro. Për diferencën prej 5.000 eurosh, ndërmjet çmimit të përcaktuar në kontratë dhe shumës së mbuluar nga tërheqjet bankare, subjekti, i pyetur nga Komisioni nëpërmjet pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se nuk i kujtohet burimi i saj, por ajo mund të jetë mbuluar nga gjendja *cash* e disponuar, e krijuar nga kursime familjare ose të ardhura të dhuruara nga babai i tij.

¹⁰ Kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.06.2010, me palë shitëse F. dhe A. V. dhe pala blerëse Elio dhe V. M., përcjellë nga subjekti me dorëzimin e deklaratës vetting.

¹¹ (i) Shkresa kthim përgjigje e ProCredit Bank, datë 16.09.2020, protokolluar në KPK me nr. {***} prot., datë 17.09.2020; (ii) Shkresa kthim përgjigje e BKT-së me nr. {***} prot., datë 11.09.2020; (ii) Shkresa kthim përgjigje e Intesa Sanpaolo Bank nr. {***} prot., datë 09.05.2023.

25.1. *Lidhur me llogarinë bankare pranë Bankës Kombëtare Tregtare*¹², në shumën 39.517 euro, konstatohet se më datë 27.01.2006, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë hapur një llogari dy emërore në euro pranë BKT-së. Gjatë vitit 2006, në këtë llogari janë kryer 13 depozitime *cash*, në vlerën totale 16.300 euro, ndërsa gjatë vitit 2007 janë kryer edhe 16 depozitime të tjera *cash* në shumën totale 20.040 euro. Për periudhën 2007 – 2010, janë përfituar interesa bankare në shumën 3.177 euro, duke arritur gjendjen përfundimtare prej 39.517,50 eurosh, shumë e cila është tërhequr më datë 02.07.2010 nga bashkëshortja e subjektit, me përshkrimin “*V. M., mbyllje depozite 1-mujore*”.

25.2. *Lidhur me llogarinë pranë ProCredit Bank ShA*¹³, në shumën 24.417 euro, konstatohet se më datë 11.01.2008, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë hapur një llogari dyemërore kursimi pranë kësaj banke. Gjatë vitit 2008, janë kryer dhe 14 depozitime *cash* në vlera të ndryshme, nga 450 euro deri në 6.300 euro, me një shumë totale prej 23.199 eurosh, e cila është shtuar më tej me interesa bankare, duke arritur në 24.417 euro. Në datën 02.07.2010, kjo shumë është tërhequr nga subjekti i rivlerësimit me përshkrimin “*tërheqje me lajmërim*”.

25.3. *Lidhur me llogarinë në Intesa Sanpaolo Bank ShA*¹⁴, në shumën 48.202 euro, konstatohet se më datë 28.03.2002, është hapur një llogari dyemërore në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij, me gjendje fillestare 2.300 euro. Gjatë periudhës 2002 – 2010, në këtë llogari janë kryer depozitime *cash* dhe janë përfituar interesa bankare, duke arritur në gjendjen përfundimtare 48.202 euro. Konkretisht, në vitin 2002 janë depozituar 8.100 euro dhe janë përfituar 97 euro interesa; në vitin 2003 janë depozituar 10.000 euro dhe janë përfituar 219 euro interesa; në vitin 2004, janë depozituar 10.475 euro dhe janë përfituar 424 euro interesa; në vitin 2005, janë depozituar 11.185 euro dhe janë përfituar 700 euro interesa; ndërsa në periudhën 2006 – 2010, nuk janë kryer depozitime të reja, por janë përfituar 4.702 euro interesa bankare. Shuma prej 48.000 eurosh është tërhequr nga bashkëshortja e subjektit me përshkrimin: “*V. M., blerje shtëpie*”.

26. Nga analiza e akteve në fashikull, rezulton se subjekti në deklaratën *vetting*, si edhe më parë në deklaratat periodike vjetore, ka deklaruar si burim të ligjshëm për financimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 129.1 m² në Tiranë, tri tërheqje nga llogaritë bankare të përshkruara më sipër, ndërkohë që nuk ka deklaruar burimin e krijimit të këtyre depozitave.
27. Gjatë hetimit administrativ, i pyetur¹⁵ nga Komisioni në lidhje me dokumentacionin justifikues ligjor për burimin e krijimit të këtyre shumave, ku të përfshihet dokumentimi i pagesës së detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, si edhe mbi mënyrën e përfitimit të këtyre të ardhurave sipas periudhave përkatëse për çdo vit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: “*Shumat e parave në këtë llogari bankare janë të ardhurat e përfituara nga puna e V. M. në degën e fondacionit “{***}”, në Shqipëri. Po ashtu, ka pasur dhe të ardhura të tjera nga përfshirja si eksperte, trajnuese, përkthyes etj., në sektorin e OJF-ve. Nuk përjashtohet që të*

¹² Referuar shkresës kthim përgjigje të Bankës Kombëtare Tregtare ShA, me nr. {***} prot., datë 11.09.2020.

¹³ Referuar shkresës kthim përgjigje të ProCredit Bank ShA, datë 16.09.2020, protokolluar në KPK me nr. {***} prot., datë 17.09.2020.

¹⁴ Referuar shkresës kthim përgjigje të Intesa Sanpaolo Bank ShA, nr. {***} prot., datë 09.05.2023.

¹⁵ Në pyetësin nr. 2.

kemi pasur dhe kursime që të kenë ndikuar në këto derdhje. Për këtë mund t'u referoheni deklaratave përkatëse të pasurisë për ato vite si dhe dokumenteve shoqëruese.

28. Për sa i përket pagesës së detyrimeve tatimore, subjekti ka deklaruar se: [...] funksionimi i organizatave jofitimprurëse në Shqipëri rregullohej me ligjin nr. 8888, datë 07.05.2001, "Për Organizatat Jofitimprurëse". Duke qenë se në kohën e hapjes së degës së fondacionit "{***}", në Tiranë, ata nuk pranonin që të hapej shoqatë më vete, por kërkonin degë të tyre në Shqipëri. ... ligji i kohës parashikonte që këto degë fondacionesh të huaja nuk regjistroheshin në gjykatë, por nisnin funksionimin e tyre në Shqipëri me një leje/pëlqim nga autoriteti përkatës shtetëror shqiptar. ... Pas disa kohësh funksionimi faktik në atë zyrë, nisur nga fakti që në Tiranë kryheshin veprimtari konkrete për projektet e {***}, iu kërkuar zyrtarisht Agjencisë Kombëtare të Mjedisit që, në përputhje me nenin 16 të ligjit nr. 7695, datë 07.04.1993, "Për Fondacionet", të lejonte ushtrimin e veprimtarisë së degës/përfaqësisë së fondacionit {***} në Shqipëri. Kërkesa u paraqit nga V. M., përfaqësuese e {***} në Tiranë. Ajo ishte e shoqëruar me një autorizim nga drejtori i {***}, z. J. D. që ajo të përfaqësonte "{***}" me cilësinë e "Consultant for Albania", të fliste e të vepronte në emër e për llogari të atij fondacioni. Autorizimi paraqet dhe faktin që detyrat e saj rrjedhin nga kuadri i projektit "Development of Albanian Citizens Organisations". ...Me shkresën nr. {***} prot., datë 01.03.2001, Agjencia Kombëtare e Mjedisit pranoi kërkesën për çeljen e zyrës lokale të "{***}", në Tiranë. [...] Të gjitha fondet që mundësonin funksionimin e shoqatës në tërësi vinin nga llogaritë bankare të fondacionit "{***}", në Vendet e Ulëta (Holandë). Po ashtu, lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore, referuar nenit 40 të ligjit nr. 8888, datë 07.05.2001, "Për Organizatat Jofitimprurëse": "Organizatave jofitimprurëse, pavarësisht nga format e organizimit, qëllimi që ndjekin dhe veprimtaritë që ushtrojnë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, që realizojnë nga dhurimet, grantet, interesat bankare dhe kuotat e anëtarësisë. Organizatat jofitimprurëse, që kryejnë veprimtari ekonomike në përputhje me nenin 36 të këtij ligji, i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat, vetëm në rast se të ardhurat e realizuara nuk destinohen për veprimtari, për të cilat organizata është regjistruar. V. Sh. M., sipas kontratës, ka qenë me detyrë "Local Consultant for Albania". ... "Mendoj që ka qenë kjo arsyeja përse është menduar që kjo e ardhur (fee) nuk duhet t'i nënshtrohej këtij tatimi. Nga ana tjetër, nëse punëdhënësi/kontraktorë të ndryshëm për të cilët ajo ka punuar (duke kryer shërbime konsulence, përkthime, punë të çfarëdo lloji sikurse janë deklaruar ndër vite), kanë zbritur detyrimet tatimore në burim sipas ligjit të kohës, mendoj që kjo duhet parë zë për zë në çdo rast pagese dhe sipas kontratave përkatëse ose dokumenteve që përfshinin palët në të tilla marrëdhënie, pa folur dhe për politikën financiare që ndiqte secili prej tyre. Nëse dikush nuk e ka përcaktuar në kontratë specifikisht që detyrimi tatimor do të duhej të paguhej nga përfituesi i shumës së shpërblimit, atëherë është logjike që të mendohet që kjo shumë duhet të jetë paguar nga dhënësi i shumës, në këtë rast punëdhënësi / kontraktori etj. [...]".
29. Bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se, si burim për krijimin e fondeve në tri depozitat bankare, të cilat janë tërhequr dhe janë përdorur për pagesën e këstit të parë në datën 02.07.2010 në shumën 112.000 euro, për likuidimin e çmimit të pasurisë objekt vlerësimi, si dhe për pagesën e këstit të dytë në datën 05.07.2010, në shumën 5.000 euro, kanë shërbyer (i) të ardhurat e personit të lidhur nga punësimi në organizata jofitimprurëse; (ii) të ardhurat e tij nga veprimtari të tjera të kryera për palë të treta, përfshirë përkthime, konsulenca dhe ekspertiza kryesisht në sektorin e organizatave jofitimprurëse (në vijim "OJF"); (iii) si dhe

të ardhura të tjera familjare. Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se burimet kryesore për krijimin e këtyre vlerave monetare lidhen me të ardhurat nga puna dhe veprimtaria e personit të lidhur për organizata jofitimprurëse dhe ente të tjera, në kuadër të projekteve të ndryshme të cilat janë verifikuar dhe analizuar në mënyrë të detajuar nga Komisioni, si vijon.

Analiza e burimeve të krijimit të tri depozitave në BKT, ProCredit dhe ISP

a) Lidhur me të ardhurat nga punësimi i subjektit në vitin 1997, pranë OSBE-së

30. Komisioni, në kuadër të analizës financiare për periudhën përpara deklaratës fillestare të pasurisë (viti 1995 – 31.12.2003), ka administruar dhe shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, duke evidentuar pasuri të tjera të deklaruara prej tij në Deklaratën e Personit që Mbart Detyrimin për Deklarim Pasurie të vitit 2003 (dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datën 26.03.2004), konkretisht llogarinë e kursimit në Bankën Italo-Shqiptare, në emër të V. M./Elio Mazreku, datë 16.05.2001, llogaria nr. {***}, në shumën prej 1.050.000 lekësh, me burim të deklaruar të ardhurat nga pagat, përkthimet, hartimi i raporteve juridike dhe kurse të tjera të subjektit dhe personit të lidhur. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, subjekti ka pretenduar se, si një ndër burimet e krijimit të llogarinë së kursimit në Bankën Italo-Shqiptare, kishin shërbyer edhe të ardhurat e përfituara prej tij nga punësimi në OSBE. Për të provuar këto të ardhura, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) kopje të dokumentit të identifikimit nga OSBE, për Elio Mazreku në cilësinë e shoqëruesit; (ii) shkresë me nr. {***} prot., datë 22.12.1997, të Prokurorisë së Përgjithshme, që vërteton emërimin e tij në Prokurorinë e Tiranës; si dhe (iii) jetëshkrimin e tij profesional, pa datë dhe dy letra reference¹⁶. Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor si marrëdhënien e punësimit, ashtu edhe të ardhurat e pretenduara nga punësimi pranë OSBE-së.
31. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka ngritur të njëjtat pretendime të paraqitura edhe në prapësimet e dërguara pranë Komisionit pas njoftimit të rezultateve të hetimit, duke parashtruar se e ka deklaruar saktë angazhimin e tij si përkthyes pranë OSBE-së në vitin 1997 dhe se, për shkak të rrethanave të kohës, duke iu referuar situatës në Shqipëri gjatë vitit 1997, kur një pjesë e dokumentacionit është humbur, gjendet në pamundësi për të siguruar dokumentacion përkatës. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.11.2023, të lëshuar nga z. A. V., me anë të së cilës, ndër të tjera, deklaroi se ka qenë gjithashtu i angazhuar si përkthyes pranë OSBE-së gjatë vitit 1997 së bashku me subjektin. Sipas subjektit, këto dokumente provojnë ekzistencën e këtij angazhimi (pa specifikuar shumën e pretenduar).
32. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni, pasi i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar me dokumentacion ligjor të ardhurat e pretenduara si të përfituara prej punësimit 1-mujor pranë OSBE-së, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për këto të ardhura, për rrjedhojë, nuk i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare.
33. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe

¹⁶ Subjekti ka paraqitur një letër reference në gjuhën angleze, të datës 01.07.1997, dhe një në gjuhën italiane të datës 03.07.1997, në të cilat referohet se z. Elio Mazreku ka qenë përkthyes gjatë muajit qershor të vitit 1997.

dokumentacionit të paraqitur prej tij, vlerëson se dokumente të tilla si jetëshkrimi profesional, referencat sipas së cilave subjekti ka qenë përkthyes gjatë muajit qershor të vitit 1997, nuk përbëjnë prova të mjaftueshme për të vërtetuar, si marrëdhënien e punësimit të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit pranë OSBE-së, ashtu edhe pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me këto të ardhura. Lidhur me deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.11.2023, nga z. A. V., ku referohet se z. V. së bashku me subjektin e rivlerësimit kanë qenë të angazhuar si përkthyes pranë OSBE-së gjatë vitit 1997, trupi gjykues referuar jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit¹⁷, e cila në shumë raste ka elaboruar gjerësisht qëndrimin se deklaratat noteriale të lëshuara gjatë procesit të rivlerësimit, si të vetme, të pambështetura nga prova të tjera, konsiderohen me vlerë të kufizuar provuese, vlerëson se deklarata e paraqitur nga subjekti nuk përbën provë të besueshme në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

34. Në rastin konkret, ky dokument i cili daton rreth 26 vite më vonë nga rrethana faktike që subjekti pretendon të provojë, duket si i konceptuar në mbështetje të pretendimit të tij. Pavarësisht pretendimeve të subjektit për vështirësitë objektive të asaj kohe në sigurimin e dokumentacionit, trupi gjykues vlerëson se, mungesa e këtij dokumentacioni pamundëson konfirmimin e pagesave / të ardhurave faktike të realizuara nga punësimi pranë OSBE-së. Në këto kushte, trupi gjykues çmoi se të ardhurat e pretenduara si të realizuara prej subjektit pranë OSBE-së, nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 1, shkronja “ç”, dhe nenit 32, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, e për rrjedhojë, ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

b) Lidhur me të ardhurat nga punësimi i bashkëshortes

35. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, Komisioni¹⁸ ka arritur në përfundimet e përmbledhura si më poshtë:

(i) Të ardhurat e përfituara nga znj. V. M., si rezultat i shërbimit të kryer në favor të personave juridikë të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, janë vlerësuar si të ardhura të ligjshme dhe si të tilla, mund të kenë shërbyer për krijimin e pasurive apo për kryerjen/mbulimin e shpenzimeve nga subjekti dhe personi i lidhur ndër vite.

(ii) Të ardhurat e përfituara nga znj. M., nga persona juridikë të regjistruar jashtë territorit shqiptar, edhe pse rrjedhin nga burime të ligjshme, ato nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk u provua pagesa e detyrimit tatimor mbi këto të ardhura, dhe për këtë arsye, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare.

b)/1 Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga punësimi i bashkëshortes së subjektit pranë fondacionit “{}”***

36. Subjekti ka pretenduar në ankim se të ardhurat (pa specifikuar shumën e tyre) e realizuara nga punësimi i bashkëshortes së tij në subjekte të regjistruara në vendet e Bashkimit Evropian, dhe

¹⁷ Për qëndrimet e mbajtura nga Kolegji lidhur me vlerën e deklaratave noteriale të lëshuara gjatë procesit të rivlerësimit, referohuni në vendimet e Kolegjit: nr. 6/2018 (JR); nr. 7/2019 (JR); nr. 34/2019 (JR); nr. 2/2020 (JR); nr. 23/2020 (JR); nr. 24/2020 (JR), për s. r. F. E.; nr. 29/2020 (JR), për s. r. E. A.; nr. 33/2020 (JR), për s. r. D. S.; nr. 11/2021 (JR), për s. r. P. K.; nr. 12/2021 (JR), për s. r. A. M.; nr. 11/2022 (JR), për s. r. E. I.

¹⁸ Shih paragrafët 26.18.151 – 26.18.167 të vendimit të Komisionit, në faqet 46-50.

që nuk janë të regjistruara në Shqipëri, nuk kanë asnjë efekt tatimor në Shqipëri, pasi ato janë audituar si dhe i janë nënshtruar legjislacionit të vendit në të cilin janë gjeneruar. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga punësimi i bashkëshortes pranë fondacionit holandez “{***}” (i cili nuk kishte seli apo personalitet juridik në vend gjatë viteve 2000 – 2009), subjekti ka parashtruar se ato janë depozituar në bankë dhe janë deklaruar rregullisht prej tij, dhe se përgjegjësia për pagesën e detyrimeve tatimore ka qenë e punëdhënësit. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti referon përgjigjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. {***} prot., datë 15.11.2023, në të cilën parashtrohet se të ardhurat personale të përfituara nga shoqëritë jorezidente në Shqipëri, nuk i nënshtrohen dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Gjithashtu, sipas subjektit, znj. V. M. nuk kishte detyrim për të deklaruar të ardhurat e saj, pasi ato nuk e kalonin kufirin e caktuar për deklarim (2.000.000 lekë). Kjo, sipas tij, e bën të pavlefshëm çdo pretendim për shkelje të ligjit për tatimin mbi të ardhurat.

37. Trupi gjykues, në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në deklaratën *vetting* bashkëshortja e subjektit ka deklaruar të ardhura nga paga si drejtuese e fondacionit “{***}” (zyra në Shqipëri) për periudhën 2000 – 2001, në shumën 18.627 marka gjermane (ekuivalente me 1.179.326 lekë), shumën 85.105 euro për periudhën 2002 – 2011, si dhe shumën 4.533.350 lekë për periudhën 2012 – 2016.

Të ardhurat për periudhën 2000 – 2001

37.1. Për të provuar të ardhurat e pretenduara nga punësimi i bashkëshortes pranë fondacionit “{***}”, në shumën 18.627 marka gjermane (ekuivalente me 1.179.326 lekë), subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

(i) “Marrëveshje për dhënie apartamenti me qira” datë 28.04.2000, e panëshkruar nga palët. Në këtë dokument parashikohet marrja me qira nga ana e “{***}” (e përfaqësuar nga personi i lidhur) e një apartamenti 2+1, të ndodhur në Tiranë, kundrejt pagesës mujore 440 DEM (Deutsch Marks) dhe 100 USD, me synim përdorimin për zyrë pa qëllime përfitimi, marrëveshje e cila hyn në fuqi në datë 01.05.2000.

(ii) Librezë pune në emër të znj. V. M., ku konstatohet se ka filluar punë në fondacionin “{***}”, në datën 01.03.2000, në pozicionin e menaxheres së përgjithshme.

(iii) Raporte vjetore të fondacionit “{***}”, për vitet 2000 dhe 2001.

(iv) Dokument në gjuhë të huaj “*Work Plan, June – December 2000*”, në të cilin znj. V. Sh. (M.), evidentohet si përfaqësuese e degës së fondacionit “{***}”, në Tiranë, Shqipëri.

(v) Dokument në gjuhë të huaj “*Project Development of Albanian and Macedonian Citizens 1999/2001*”, për periudhën 1999 – 2001, ku është parashikuar se fondi për pagesën e punonjësit në Shqipëri (konsulentit) do të ishte 7.455 marka gjermane (DEM) për 6-muaj.

(vi) Dokumenti në gjuhë të huaj, shkresë e thjeshtë “*Project Development of Albanian and Macedonian Citizens 1999/2001*”, për periudhën 1999 – 2001, është parashikuar se fondi për pagesën e punonjësit në Shqipëri (konsulentit) do të ishte 27.336 marka gjermane (DEM) për

22 muaj, por në përmbajtjen e këtij dokumenti nuk evidentohen parashikime/rregulla mbi mënyrën e pagesës së detyrimeve tatimore.

37.2. Referuar ekstraktit të llogarisë bankare të znj. V. M. pranë Intesa Sanpaolo Bank ShA (ish-banka Italo-Shqiptare)¹⁹, evidentohet: (i) transaksion i datës 31.12.2001, me vlerë 1.457 euro, me përshkrimin “2.850,88/DEM këmbim nga DEM në llogarinë në euro”; (ii) në datën 22.01.2002 kreditohen 5.000 euro me përshkrimin: “Nga {***} në favor të V. Sh.”; (iii) në datën 15.02.2002, janë kredituar 20.000 euro me përshkrimin “{***} në favor të V. Sh., avancë për kosto projekti”.

Të ardhurat për periudhën 01.05.2002 – 31.12.2009

37.3. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit, rezultoi se, në deklaratën fillestare të personit që mbart detyrimin për deklarim, të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pagën e bashkëshortes në masën 630 euro/muaj dhe në ndarjen “Detyrime fiskale” ka deklaruar “sigurim vullnetar”. Në DIPP-të e viteve 2004 – 2009, subjekti ka deklaruar çdo vit të ardhura nga punësimi i bashkëshortes në këtë fondacion, në shumën totale prej 55.000 eurosh. Ndërsa, në deklaratën *vetting* nuk i ka deklaruar të ardhurat e bashkëshortes. Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting* të personit të lidhur, ka deklaruar: “Të ardhura nga paga si drejtuese e Fondacionit “{***}” (Zyra Shqipëri) (sot, “{***}” Shqipëri, NIPT {***}). Adresa: Rr. {***}, P. {***}, Ap. {***}, Tiranë. Pagesa fillimisht bëhej me monedhë holandeze (guilder), që konvertohej në marka gjermane. Me hyrjen në treg të monedhës euro, pagesa nga viti 2002, mu bë në euro. Në vijim, pas regjistrimit dhe daljes si degë më vete, pagesa është bërë në lekë. Paraqes disa kontrata pune”. Të ardhura nga punësimi i saj pranë fondacionit “{***}” të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, janë: i) 18.627 marka gjermane; (ii) 85.105 euro; dhe (iii) 4.533.350 lekë.

37.4. Për të provuar të ardhurat e pretenduara të përfituara nga bashkëshortja e tij, subjekti, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, ka paraqitur disa marrëveshje punësimi të lidhura ndërmjet bashkëshortes së tij dhe fondacionit “{***}”, në të cilat ajo angazhohej si përfaqësuese lokale e zyrës në Shqipëri. Në këto kontrata janë përcaktuar detajet e angazhimit, kushtet financiare dhe shumat mujore të kompensimit, si më poshtë vijon:

i) Marrëveshje punësimi “*Agreement*”, e datës 05.03.2003, për periudhën 01.05.2002 – 30.04.2005, në të cilën përcaktohet se tarifa mujore “*monthly fee*” ishte 511 euro deri në tetor 2002, dhe 600 euro deri në dhjetor 2003. Ndërsa, për vitet 2004 dhe 2005, parashikohej rritje vjetore prej 5% (respektivisht 630 euro dhe 660 euro) dhe pagesa e taksave dhe/ose sigurimeve shoqërore është përgjegjësi e përfaqësuesit lokal në Shqipëri (në këtë rast V. M.).

ii) Marrëveshje punësimi “*Agreement*”, e datës 05.12.2005, për periudhën 01.05.2005 – 31.12.2006, në të cilën përcaktohet se tarifa mujore “*monthly fee*” ishte 725 euro. Gjithashtu, në këtë marrëveshje përcaktohet se pagesa e taksave dhe/ose sigurimeve shoqërore është përgjegjësi e përfaqësuesit lokal në Shqipëri.

iii) Marrëveshje e përgjithshme punësimi “*Framework Agreement*”, e datës 03.04.2007, për periudhën 01.04.2007 – 31.12.2007. Në këtë marrëveshje nuk janë përcaktuar përfitimet

¹⁹ Shkresa kthim përgjigje e ISP Bank nr. {***} prot., datë 18.09.2020.

financiare. Në përmbajtjen e saj përmenden tre anekse, të cilat nuk rezultojnë të jenë të përfshira në dosjen e administruar.

37.5. Marrëveshja e përgjithshme e punësimit “*Framework Agreement*”, datë 01.01.2008, për periudhën 01.01.2008 – 31.12.2010, parashikon që për periudhën 01.04.2008 – 31.12.2008, tarifa mujore “*monthly fee*”, të jetë 800 euro në muaj, ndërsa për periudhën 01.01.2009 – 31.12.2010 të jetë 1.000 euro në muaj. Marrëveshja nuk përcakton përfitim financiar për tre muajt e parë të vitit 2008. Pagesa e detyrimeve tatimore është përcaktuar si përgjegjësi individuale e znj. V. M.

38. Komisioni, ka konstatuar subjekti, nuk ka përcaktuar shumën e të ardhurave të pretenduara në lidhje me punësimin e personit të lidhur, për rrjedhojë, në rezultatet e hetimit ka përllogaritur këto të ardhura duke u bazuar në dokumentacionin e përshkruar më sipër, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht:

(i) Bazuar në marrëveshjen e datës 05.03.2003, Komisioni ka përllogaritur të ardhurat e pretenduara nga subjekti për periudhën 01.05.2002 – 30.04.2005, në shumën 22.026 euro.

(ii) Bazuar në marrëveshjen e vitit 2005, për periudhën 01.05.2005 – 31.12.2006, Komisioni ka përllogaritur të ardhurat në shumën 14.500 euro.

(iii) Në marrëveshjen e datës 03.04.2007, që mbulon periudhën 01.04.2007 – 31.12.2007, nuk është përcaktuar përfitimi financiar për këtë periudhë. Komisioni ka vlerësuar ti përllogarisë të ardhurat e pretenduara nga subjekti për periudhën 01.04.2007 – 31.12.2007, bazuar në marrëveshjen që mbulon periudhën e mëparshme të punësimit, sipas së cilës bashkëshortja e subjektit është paguar me 725 euro/muaj. Pra, në total për të gjithë periudhën, në shumën prej 6.525 euro.

(iv) Bazuar në marrëveshjen e datës 01.01.2008, që mbulon periudhën e punësimit 01.04.2008 – 31.12.2010, rezulton se, znj. M., për periudhën 01.04.2008 – 31.12.2008, do të paguhej në shumën 800 euro / muaj, ndërsa për periudhën 01.01.2009 – 31.12.2010, do të paguhej në shumën 1.000 euro/muaj. Përfitimi total i pretenduar për periudhën 2008 – 2010, është parashikuar të jetë 31.200 euro, ndërsa, deri në qershor 2010, periudha para likuidimit të vlerës së apartamentit, përllogaritet të jetë 25.200 euro.

38.1. Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, Komisioni ka arritur në përfundimin se: “*Bazuar në deklaratimet e bëra, si dhe në dokumentacionin e depozituar – pjesë e dosjes së hetimit administrativ – duket se për periudhën 2000 – 2011, personi i lidhur mund të ketë përfituar në total të ardhura nga puna e saj, në fondacionin “{***}”, vlerat monetare si vijon: (i) 18,627 marka gjermane (ekuivalenti i shumës prej rreth 1,179,000 lekësh); (ii) shumën rreth 76,000 euro, nga ku, siç u evidentua edhe më sipër, për periudhën para likuidimit të çmimit të pasurisë objekt vlerësimi vlerat e mundshme të të ardhurave të përfituara janë 18,627 marka gjermane dhe 68,251 euro”.*

38.2. Me rezultatet e hetimit, Komisioni i ka njoftuar subjektin konkluzionin paraprak se: “*Në analizë të gjithë të dhënave të mësipërme, duket se ekzistojnë indicie dhe prova të besueshme të cilat tregojnë se personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për periudhën 2000 – 2011, ka patur marrëdhënie të vazhdueshme financiare me fondacionin “{***}” dhe se ka përfituar të ardhura nga puna e kryer për këtë fondacion. Komisioni konstaton se, subjekti i*

*rivlerësimi/personi i lidhur nuk ka depozituar dokumentacion në formën e kërkuar nga ligji për përfitim të të ardhurave në monedhën marka gjermane për periudhën 2000 – 2001. Gjithashtu, rezulton se subjekti nuk ka provuar pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga bashkëshortja e tij prej punës në fondacionin “{***}”, për periudhën 2000 – 2011”.*

39. Me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, në kundërshtim të barrës së provës mbi provueshmërinë me dokumentacion ligjor të të ardhurave të pretenduara nga punësimi i personit të lidhur për periudhën 2000 – 2009, subjekti, krahas dokumentacionit të sipërpërmendur, ka paraqitur edhe fatura të tipit “Receipt”, të lëshuara në emër të personit të lidhur, përmes të cilave pretendohet dokumentimi i pagesave mujore për angazhimin e saj si përfaqësuese lokale pranë fondacionit “{***}”. Vlerat e pasqyruara në këto dokumente për periudhën 2002 – 2009, përputhen me pagesat e përcaktuara në marrëveshjet përkatëse të depozituara nga subjekti, ndërsa për periudhën 2000 – 2001 nuk është paraqitur dokumentacion provues mbi ekzistencën e marrëdhënies së punësimit. Subjekti ka paraqitur gjithashtu listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për vitet 2010 dhe 2011, së bashku me formularët për likuidimin e këtyre detyrimeve.
40. *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga puna e personit të lidhur në fondacionin “{***}”, për vitet 2010 dhe 2011, Komisioni, pas vlerësimit dhe shqyrtimit përfundimtar të shpjegimeve të dhëna nga subjekti nëpërmjet prapësimeve të depozituara pas rezultateve të hetimit, të shpjegimeve në seancë dëgjimore, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, ka konstatuar se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit përmbush kushtet e përcaktuara në nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, këto të ardhura janë pasqyruar dhe reflektuar në analizën financiare përfundimtare.*
41. *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga puna e personit të lidhur në fondacionin “{***}” për periudhën para vitit 2010, si dhe të ardhurat e tjera nga marrëdhënia e punës/shërbimit me persona juridikë të regjistruar brenda dhe jashtë territorit shqiptar, Komisioni ka konkluduar se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është ligji bazë mbi të cilin rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat në tri kategori kryesore: (i) tatimi mbi të ardhurat personale; (ii) tatimi mbi fitimin; (iii) tatimi i mbajtur në burim i të ardhurave. Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit në fuqi.*
42. Subjekti, në ankim, ka kundërshtuar konkluzionin e Komisionit lidhur me moskonsiderimin si të ligjshme të të ardhurave të përfituara nga puna/shërbimet e kryera nga personi i lidhur për persona të tjerë juridikë, për të cilat nuk ka rezultuar e provuar pagesa e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat, duke argumentuar se: (i) kryesisht këto organizata kanë qenë të regjistruara si OJF, dhe si të tilla, kanë qenë të përjashtuara nga detyrimet tatimore; (ii) marrëdhënia e personit të lidhur me këto subjekte ka qenë marrëdhënie shërbimi, ndaj detyrimi për mbajtjen dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat i takonte personave juridikë; (iii) të ardhurat e përfituara nga persona juridikë të regjistruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nuk mund t'i nënshtroheshin tatimit të dyfishtë; si dhe (iv) legjislacioni për tatimin mbi të ardhurat nuk e detyronte personin e lidhur të ishte subjekt deklarues, për sa kohë të ardhurat vjetore nuk tejkalonin shumën 2 milionë lekë, duke referuar se deklarimi individual i të ardhurave ka filluar të zbatohet nga viti 2011.

42.1. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se është në pamundësi për të provuar se punëdhënësi ka shlyer detyrimet tatimore, për shkak të kohës së largët që ka kaluar, duke u referuar në ankim se: *“V. M. ka bërë tërë përpjekjet dhe ka gjetur tërë dokumentet e mundshme për rastin e vet. Këtu duhet pasur parasysh që fondacioni holandez është mbyllur dhe nuk ka më asnjë mundësi që të kërkojmë të dhëna ose të marrim dokumente të tjera në një vend pas shumë vitesh”*. Ndërsa në parashtrimet e dërguara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit është shprehur se: *“... sa kam pretenduar në ankim për pamundësinë e organeve shtetërore që të japin një tablo të qartë të regjistrimit të saj në ISSH, në organet tatimore, dhe të pagesave të kontributeve të bashkëshortes ndër vite, qëndrojnë plotësisht. Sërish i qëndroj mendimit tim që përgjigjet e cunguara nga Drejtoria Rajonale Tatimore nuk mund të jenë “mbretëreshë e provave” dhe të merren të mirëqena. Vlera e tyre duhet parë në përputhje me tërë provat e tjera shkresore, duke përfshirë dhe deklaratimet tona si dhe duhen vlerësuar sipas një logjike veprimi dhe logjikës së ligjeve në fuqi në periudhën në fjalë. Ky lloj hetimi administrativ nuk mund të provonte dhe nuk mund të prodhonte rezultate njëqind për qind të vërteta, të besueshme për vetë faktin që arkivat e institucioneve shqiptare nuk janë plotësisht të besueshme”*.

42.2. Subjekti i rivlerësimit, në ankim ka referuar shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (në vijim “DPT”) me nr. {***} prot., datë 15.11.2023, të paraqitur prej tij edhe në prapësimet e dërguara pas njoftimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni, duke pretenduar se përgjigja e cunguar e këtij institucioni, nuk mund të përbëjë shkak për moskonsiderimin si të ligjshme të të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja e tij. Në përgjigjen e saj, DPT ka sqaruar se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikon që llogaritja, mbajtja dhe pagesa e detyrimit tatimor kryhen, në parim, nga tatimpaguesi që realizon pagesën dhe është i regjistruar në administratën tatimore në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, DPT-ja ka referuar nenin 8 dhe nenin 8/1 të këtij ligji, sipas të cilëve përjashtohen nga tatimi të ardhurat e përfituara në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë. Në përfundim, DPT ka sqaruar se të ardhurat personale të përfituara nga shoqëri jorezidente në Republikën e Shqipërisë, konkretisht fondacioni “{***}” (Holandë), organizata {***}, {***}²⁰, {***}²¹, “{***}” (Austri), “{***}” (Austri), “{***}” (Austri), kompania “{***}” A/S (Danimarkë) dhe kompania “{***}” Projekti Hot-Spot (Austri), nuk i nënshtrohen dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

43. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit në raport me legjislacionin e zbatueshëm, në drejtim të marrëdhënies së bashkëshortes së tij me shoqëritë jorezidente në Republikën e Shqipërisë, duke i analizuar secilën prej tyre në mënyrë të detajuar, sikurse paraqitet në vijim.
44. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit nga fondacioni “{***}”, trupi gjykues konstatoi se ekzistojnë *indicie* dhe prova të besueshme, të cilat tregojnë se për periudhën 2002 – 2009, ajo ka pasur marrëdhënie të vazhdueshme financiare me këtë fondacion dhe ka përfutuar të ardhura bazuar në disa marrëveshje të nënshkruara me këtë fondacion, në të cilat ajo indentifikohej si përfaqësuese lokale e këtij fondacioni, në cilësinë e sekretares teknike, koordinatores dhe konsulentes, për zyrën në Shqipëri të këtij fondacioni, kundrejt përfitimit të

²⁰ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim.

²¹ Fondi i Kombeve të Bashkuara për Gratë.

pagesave për periudha disa-mujore sipas marrëveshjeve përkatëse, në të cilat, për periudhën 2001 – 2007, pagesa përshkruhej si “monthly fee”. Ndërsa, marrëveshjen e nënshkruar për periudhën 01.04.2008 – 31.12.2008, pagesat janë përshkruar si “gross salary”. Në këto marrëveshje (përfshirë atë të vitit 2007), specifikohet se përgjegjësia për pagesën e detyrimeve tatimore i përkiste përfaqësues lokale/ znj. M. Pavarësisht këtij përcaktimi të dakordësuar mes palëve, bashkëshortja e subjektit për periudhën në analizë (2002–2009), gjatë së cilës duket se ka qenë e punësuar me kohë të plotë. Trupi gjykues vëren se edhe në versionin që znj. M. ka pasur një marrëdhënie shërbimi me fondacionin “{***}”, përsëri duket se ajo ka zgjedhur që shërbimin e saj ta ofrojë duke mos u regjistruar në organet tatimore si person fizik apo juridik.

45. Pas njoftimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni, për të dokumentuar pagesat mujore të përfituara nga bashkëshortja e tij për angazhimin e saj si përfaqësuese lokale pranë fondacionit “{***}”, subjekti ka paraqitur disa fatura me përshkrimin “Receipt”, në të cilat personi i lidhur deklaron përfitimin e shumave të caktuara nga fondacioni “{***}”, në cilësinë e konsulentës, për periudhat e specifikuara në secilin dokument, të cilat rezultojnë të nënshkruara prej saj. Trupi gjykues vëren se, ndonëse vlerat e pasqyruara në këto dokumente për periudhën 2002 – 2009, përputhen me pagesat e përcaktuara në marrëveshjet përkatëse të depozituara nga subjekti (përfshirë periudhën 2000 – 2001, për të cilën nuk ka marrëveshje), këto dokumente të firmosura prej vetë bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. M., nuk përmbajnë elementët e detyrueshëm formalë të dokumentacionit financiar, si numrin e faturës, të dhënat identifikuese të plota të palëve, numrin fiskal/NIPT, vlerën e detyrimit tatimor, si dhe elementë të tjerë të kërkuar nga legjislacioni tatimor dhe ai i kontabilitetit, për rrjedhojë nuk u konsideruan si të besueshme prej tij. Në eventualitetin e këtyre fakteve, trupi gjykues analizoi secilin pretendim të subjektit të rivlerësimit sa i takon të ardhurave në analizë dhe konstatoi sa vijon.

45.1. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kryesisht organizatat nga të cilat janë përfituar të ardhurat nga bashkëshortja e tij, kanë qenë të regjistruara si OJF dhe, si të tilla, kanë qenë të përjashtuara nga detyrimet tatimore, trupi gjykues vëren se statusi formal si OJF, nuk përjashton *a priori* mungesën e detyrimeve tatimore. Legjislacioni tatimor shqiptar bazohet në parimin e realitetit ekonomik të veprimtarisë, dhe jo vetëm në formën juridike të një subjekti dhe, përjashtimet nga detyrimet tatimore interpretohen *stricta lege*, dhe jo mbi bazën e prezumimeve. Po ashtu, trupi gjykues, në analizë të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, që rregullon statusin e OJF-ve,²² vëren se regjistrimi i një subjekti si organizatë jofitimprurëse rezidente ose jorezidente, nuk sjell *ipso jure* përjashtim të plotë nga detyrimet tatimore, por vetëm përjashtime të kufizuara dhe të kushtëzuara, të cilat aplikohen në varësi të natyrës së aktivitetit dhe llojit të të ardhurës së realizuar²³. Në këtë kuptim, çdo subjekt

²² Në nenin 13 të ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001, “Për organizatat jofitimprurëse”, përcaktohet se: Organizatat jofitimprurëse, subjekte të këtij ligji, fitojnë personalitetin juridik pasi të jenë themeluar dhe regjistruar në gjykatë, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Të njëjtave procedura të regjistrimit iu nënshtrohen edhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja.

²³ Në nenin 40 të këtij ligji përcaktohet se: “Lehtësitë dhe përjashtimet e organizatave jofitimprurëse nga detyrimet tatimore dhe doganore caktohen me ligj. Organizatat jofitimprurëse, pavarësisht nga forma e organizimit, qëllimi që ndjekin dhe veprimtaritë që ushtrojnë, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat që realizohen nga dhurimet dhe kuotat e anëtarësisë”. Ndërsa në nenin 41 të tij, përcaktohet se: “Organet kompetente shtetërore kanë të drejtë të

që pretendon përjashtimin nga përgjegjësia tatimore, duhet të provojë shprehimisht se plotëson kriteret ligjore për përjashtimin, ose në rastin e OJF-ve jorezidente, sikurse është edhe rasti në shqyrtim, të provojë me dokumentacion ligjor mbajtjen e tatimit në burim në vendin e origjinës. Në këto kushte, në mungesë të provave mbi mbajtjen e tatimit në burim, pretendimi se të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit burojnë nga organizata të “përjashtuara nga detyrimet tatimore”, konsiderohet deklarativ dhe i pambështetur në prova e në ligj.

45.2. *Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se marrëdhënia e personit të lidhur me këto subjekte²⁴ ka qenë marrëdhënie shërbimi, ndaj detyrimi për mbajtjen dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat i takonte personave juridikë.* Në analizë të këtij pretendimi, trupi gjykues vlerëson se, përcaktimi i natyrës juridike të marrëdhënies ndërmjet palëve, mbështetet në një qasje substanciale dhe jo formale, ku rëndësi vendimtare merr realiteti konkret i marrëdhënies së krijuar ndërmjet palëve, dhe jo emërtimi formal i kontratës apo marrëveshjes së nënshkruar mes palëve, pra prevalon realitetit ekonomik dhe juridik ndaj formës së aktit. Në jurisprudencën e tij, Kolegji²⁵ ka identifikuar disa si kriterë orientues për të dalluar marrëdhënien e shërbimit nga marrëdhëniet e tjera juridike, veçanërisht nga marrëdhënia e punës. Një ndër elementet kryesore është ekzistenca ose jo e pavarësisë profesionale të ofruesit të shërbimit. Nëse individi ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur dhe nuk i nënshtrohet kontrollit të drejtpërdrejtë të subjektit kontraktues, atëherë marrëdhënia orientohet drejt një marrëdhënieje shërbimi. Në të kundërt, kur puna kryhet nën drejtimin, mbikëqyrjen dhe organizimin e subjektit, kemi tregues tipikë të një marrëdhënieje pune. Po ashtu, rëndësi paraqet edhe mënyra e pagesave dhe vijimësia e marrëdhënies financiare. Në këtë këndvështrim, pagesat periodike përbëjnë indikator të marrëdhënies së punës, veçanërisht kur individi kryen funksione të përhershme dhe jo të rastësishme. Ndërsa pagesa për projekt, për rezultat, ose për shërbime të posaçme e të kufizuara në kohë, zakonisht lidhet me një marrëdhënie shërbimi.

45.2.1. Një aspekt tjetër me relevancë juridike është trajtimi i të ardhurave të realizuara, në këndvështrim të mënyrës së mbajtjes dhe pagesës së tatimeve e kontributeve shëndetësore. Në marrëdhënien e punës, detyrimet tatimore dhe ato për pagesën e kontributeve, zakonisht mbahen dhe deklarohen nga punëdhënësi, ndërsa në marrëdhënien e shërbimit, individi vepron si subjekt i pavarur dhe mban vetë përgjegjësi për detyrimet tatimore. Ky element, megjithëse jo vendimtar më vete, shërben si tregues plotësues në analizën e përgjithshme të marrëdhënies. Nga aktet rezulton se personi i lidhur ka ushtruar funksionin e përfaqësueses lokale të fondacionit “{***}”, me seli në Holandë, në mënyrë të vazhdueshme dhe për një periudhë relativisht të gjatë kohore. Marrëdhënia nuk paraqitet si angazhim sporadik apo shërbim i kufizuar në realizimin e projekteve të caktuara, por si një angazhim i qëndrueshëm dhe i integruar në veprimtarinë e subjektit të huaj. Vetë funksioni i “përfaqësueses lokale” nënkupton ushtrimin e aktivitetit në emër dhe për llogari të fondacionit, duke krijuar një lidhje të

mbikëqyrin organizatat jofitimprurëse për sa i përket zbatimit të legjislacionit tatimor, doganor, të sigurimeve shoqërore, të lejimit të ushtrimit të veprimtarisë ekonomike ...”.

²⁴ *Subjekti përmend “{***}” (Holandë), {***}, {***}, {***}, “{***}” (Austri), “{***}” (Austri), “{***}” (Austri), “{***}” (Danimarkë) dhe “{***}” (Austri), por për efekt analize, këtu i referoheni vetëm fondacionit “{***}”.*

²⁵ *Shih vendimet e Kolegjit: nr. 5/2023 (JR), datë 21.02.2023; nr. 2/202 (JR), datë 27.02.2020 dhe nr. 2/2024 (JR), datë 24.01.2024.*

vazhdueshme organizative dhe funksionale me të. Gjithashtu, mënyra e pagesës përbën një tregues domethënës mbi natyrën reale të marrëdhënies. Pagesat janë kryer në formën e pagave bruto me përshkrimin “monthly fee” dhe “gross salary”²⁶, terminologji kjo që lidhet zakonisht me shpërblimin periodik, për një angazhim të vazhdueshëm profesional dhe jo domosdoshmërisht me një shërbim të pavarur të rastësishëm i cili shpërblehet në përfundim të realizimit të tij. Përdorimi i termit “gross salary” [pagë bruto], evidenton një nga elementet thelbësore të një marrëdhënieje pune ose të paktën të një marrëdhënieje të varur ekonomikisht, ku pagesa lidhet me vijimësinë e funksionit dhe jo vetëm me rezultatin konkret të një shërbimi të caktuar.

45.2.2. Në përfundim, bazuar në kohëzgjatjen e marrëdhënies, natyrën e funksionit të ushtruar, mënyrën e pagesës dhe mungesën e elementeve të mirëfillta të pavarësisë profesionale si “përfaqësuese lokale”, trupi gjykues vlerëson se marrëdhënia e personit të lidhur me fondacionin “{***}” nuk mbart karakteristikat e një marrëdhënie të shërbimi sikurse ka pretenduar subjekti. Trupi gjykues, në funksion të vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave të përfituara nga znj. M. nga puna e ofruar për fondacionin “{***}”, mbajti në konsideratë edhe detyrën që ajo ka ushtruar gjatë periudhës kur këto marrëveshje janë nënshkruar dhe parashikimet eksplicite në to lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore. Znj. M., në cilësinë e “përfaqësueses lokale” në disa akt-marrëveshje, ka pasur përgjegjësinë direkte për pagimin e detyrimeve tatimore, ndërsa në rastet e tjera ky detyrim ka qenë përcaktuar si përgjegjësi individuale e saj. Edhe në versionin që kjo marrëdhënie ka qenë një marrëdhënie shërbimi, trupi gjykues vlerësoi se znj. M. ka zgjedhur të ushtrojë në mënyrë të vazhdueshme një veprimtari konsulence/shërbimi, pa deklaruar të ardhurat e përfituara dhe paguar detyrimet tatimore lidhur me to, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi tatimor²⁷. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se, pavarësisht natyrës së kësaj marrëdhënieje, për sa kohë subjekti nuk arriti të provojë pagimin e detyrimeve tatimore sipas përcaktimeve në marrëveshjet e referuara më sipër, të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e tij nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme, për shkak të mos pagimit të detyrimeve tatimore lidhur me to.

45.3. *Në analizë të pretendimit të subjektit se të ardhurat e përfituara nga persona juridikë të regjistruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nuk mund t’i nënshtroheshin tatimit të dyfishtë*, trupi gjykues vëren se pagesa e tatimeve në një shtet të huaj nuk përjashton automatikisht lindjen e detyrimeve tatimore në një shtet tjetër. Legjislacioni shqiptar për përcaktimin e përgjegjësisë tatimore, bazohet në parimin e burimit të të ardhurës dhe të ushtrimit faktik të aktivitetit ekonomik në territorin e Republikës së Shqipërisë, në respektim edhe të marrëveshjeve dypalëshe që shteti shqiptar ka nënshkruar me shtete të tjera, me qëllim shmangien e tatimit të dyfishtë. Në këtë këndvështrim, çdo subjekt jorezident që ushtron aktivitet përmes një pranije faktike në territorin shqiptar mund t’i nënshtrohet juridiksionit tatimor shqiptar, pavarësisht regjimit fiskal që ndjek në vendin e origjinës. Në rastin konkret, fondacioni “{***}”, sipas pretendimit të subjektit, mund të ketë deklaruar ose paguar tatime në shtetin ku është i regjistruar, por për sa kohë ky fondacion ka operuar nëpërmjet përfaqësueses

²⁶ Termi “gross salary” nënkupton një shumë fikse parash të rënë dakord çdo vit, që i paguhet një punonjësi dhe zakonisht depozitohet direkt në bankë (pagë vjetore), pra shuma totale e fituar para se të mbahen tatimet apo kontributet. Shih: <https://dictionary.cambridge.org/example/english/gross-salary>.

²⁷ Interpretimi dhe zbatimi i këtij legjislacioni trajtohet në vijim në vendim.

lokale në territorin shqiptar dhe ka kryer pagesa ndaj saj, subjekti ka pasur detyrimin të provonte me dokumentacion ligjor se tatimi në burim për këto pagesa është mbajtur prej këtij fondacioni, në përputhje me përcaktimet e neneve 33 dhe 35 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

45.3.1. Trupi gjykues evidenton se, përkundër nga sa pretendon subjekti, nga aktet, rezultoi e provuar se në 3²⁸ nga 4 marrëveshjet e lidhura mes personit të lidhur dhe fondacionit “{***}”, është përcaktuar shprehimisht se përgjegjësia për pagesën e taksave dhe sigurimeve shoqërore është e përfaqësuesit lokal në Shqipëri, pra e znj. M. Lidhur me këtë situatë faktike, trupi gjykues çmon të sjell në vëmendje përcaktimet ligjore të kohës, me qëllim identifikimin e përgjegjësive tatimore të personit të lidhur. Në këtë optikë, trupi gjykues vëren se, në nenin 7, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, përcaktohej se: *“Individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore, për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu”*. Në nenin 4 të tij, ky ligj përcakton burimet e të ardhurave, pa i kufizuar ato vetëm në burimet e renditura në këtë dispozitë²⁹. Në nenin 8 të këtij ligji përcaktohen kategoritë e të ardhurave të tatueshme, për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale. Me ndryshimet e mëvonshme ligjore (me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003), në pikën 1, të nenit 8, me titull “Të ardhura të tatueshme”³⁰ të këtij

²⁸ Në 1 marrëveshje, nuk rezulton të jetë evidentuar përgjegjësia për pagesën e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore (marrëveshja e vitit 2007, të cilës i mungojnë anekset bashkëlidhur).

²⁹ “Të ardhurat nga një burim në Republikën e Shqipërisë, pa u kufizuar vetëm në to, do të përfshijnë të ardhurat si vijon: a) Të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar në Republikën e Shqipërisë; b) të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale në Republikën e Shqipërisë; c) të ardhurat nga veprimtaria e zhvilluar nga një person jorezident, nëpërmjet një personi me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; d) të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme, që i përfiton një person me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; dh) të ardhurat nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme, aksesoret dhe frytet e tyre, si dhe të ardhurat nga të drejta të tjera, që rrjedhin nga pronësia mbi sendet e paluajtshme, në rast se këto sende ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë; e) të ardhurat nga kalimi i pronësisë mbi pasuritë e parashikuara në germën “dh” të këtij neni; ë) të ardhurat nga dividendët e shpërndarë nga një person juridik, rezident; f) të ardhurat nga pjesët e fitimit, të paguar nga një ortakëri rezidente; g) të ardhurat nga interesat e paguar nga organet e qeverisjes qendrore apo vendore ose nga një rezident i Republikës së Shqipërisë, ose që paguhet nga një jorezident, nëpërmjet një personi që ka seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë; gj) të ardhurat nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale, qiraja dhe enfiteoza; h) të ardhurat e tjera, të përfituara nga një jorezident, nëpërmjet një personi me seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë.

³⁰ Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: a) pagat dhe shpërblimet e tjera, në lidhje me marrëdhëniet aktuale të punës; Përfshihen të ardhurat nga pagat dhe shpërblimet për marrëdhëniet e punës të zyrtarëve të konsullatave, diplomatit, ose funksionarë të ngjashëm të vendeve të tjera, si dhe të organizatave ndërkombëtare, të cilët, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me konventat ose marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara, ose të pranuar nga Republika e Shqipërisë apo Qeveria Shqiptare, kanë statusin e diplomatit. Nuk i nënshtrohen përjashtimeve të këtij paragrafi individët, shqiptarë apo të huaj, të cilët nuk gëzojnë statusin e diplomatit, të njohur nga konventat apo marrëveshjet ndërkombëtare për këtë qëllim; b) të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionarit në shoqërinë tregtare; c) të ardhurat nga interesat bankarë apo ato të përfituara nga letrat me vlerë, me përjashtim të interesave të marra nga bonot e thesarit ose letra të tjera më vlerë të Qeverisë të emetuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji; ç) të ardhurat që rrjedhin nga e drejta e autorit dhe pronësia intelektuale; d) të ardhurat nga enfiteoza, huaja dhe qiratë, më përjashtim të rasteve, kur të ardhurat janë realizuar nga zhvillimi i një veprimtarie tregtare, në kuptim të legjislacionit tregtar; dh) të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme; e) të ardhurat e individëve nga lojërat e fatit dhe kazinotë”.

ligji, u shtua shkronja “g”, me përmbajtjen: “g) të ardhura të tjera, që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”. Pra, sikurse vërehet së paku nga muaji janar i vitit 2004, kur ka ndodhur ky ndryshim ligjor, pavarësisht llojit të marrëdhënies “pune” apo “shërbimi”, ligji nuk lë hapësira interpretimi, pasi i ka përfshirë të gjitha kategoritë e të ardhurave të përfituara, si të tatueshme. Në vijim, situata e rregullimit ligjor të të ardhurave të tatueshme në një dimension edhe më gjithëpërfshirës, u plotësua edhe me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit të sipërcituar mbi tatimin mbi të ardhurat. Konkretisht, referuar pikës 2.3.1, të udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në pikën 2.3.9, paragrafi 2, të udhëzimit nr. 5, përcaktohej se: “Në rastet kur përfituesi është individ rezident shqiptar dhe paguesi është person jorezident (i paregjistruar në organet tatimore shqiptare), përfituesi i të ardhurave duhet të deklarojë dhe paguajë tatimin në organin tatimor përkatës jo me vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa”. Ndërsa, në nenin 7 të po këtij udhëzimi, përcaktohej se individët rezidentë i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore për të gjitha burimet e të ardhurave (brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë).

45.3.2. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nga marrëdhënia me fondacionin “{***}”, kanë qenë objekt i aplikimit të tatimit në burim mbi të ardhurat personale. Në këtë optikë, trupi gjykues vlerëson se personi i lidhur, në raport me organet tatimore, ka vepruar në keqbesim ndaj pagimit të këtyre detyrimeve, ndërkohë që ka pasur detyrimin në zbatim të parashikimeve eksplicite në marrëveshjet përkatëse dhe përcaktimeve ligjore e nënligjore të përshkruara më sipër, për deklarimin e të ardhurave dhe pagimin e detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat personale, në organin përkatës tatimor të Republikës së Shqipërisë.

45.4. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjithashtu, se të ardhurat e përfituara nga persona juridikë të regjistruar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk mund t’i nënshtroheshin tatimit të dyfishtë dhe, se është në pamundësi për të provuar se punëdhënësi ka shlyer detyrimet tatimore, për shkak të kohës së largët që ka kaluar. Në mbështetje të pretendimit të tij, subjekti ka referuar shkresën e DPT-së drejtuar Komisionit, me nr. {***} prot., datë 15.11.2023, në të cilën shpjegohet se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikon që llogaritja, mbajtja dhe pagesa e detyrimit tatimor kryhen, në parim, nga tatimpaguesi që realizon pagesën dhe është i regjistruar në administratën tatimore në Republikën e Shqipërisë. Po ashtu, në këtë shkresë referohet neni 8 dhe neni 8/1 i ligjit të sipërcituar, sipas të cilëve përjashtohen nga tatimi të ardhurat e përfituara në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe se “... të ardhurat personale të përfituara nga shoqëri jorezidente në Republikën e Shqipërisë, konkretisht “{***}” (Holandë), {***}, {***}, {***}, “{***}” (Austri), “{***}” (Austri), “{***}” (Austri), “{***}” (Danimarkë) dhe “{***}” (Austri), nuk i nënshtrohen dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar”.

45.5. Në analizë të pretendimit të subjektit, trupi gjykues vëren në nenin 8 dhe nenin 8/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, përcaktohet se “... të ardhurat personale të përfituara nga shoqëri jorezidente në Republikën e Shqipërisë, nuk i nënshtrohen dispozitave të këtij ligji”. Në këtë kuadër, shteti shqiptar ka nënshkruar

marrëveshje me shtete të tjera, me qëllim shmangien e tatimit të dyfishtë. Megjithatë, këto marrëveshje nuk përjashtojnë automatikisht detyrimet e një subjekti jorezident që mund të lindin në shtetin shqiptar, por vetëm koordinojnë mënyrën e ushtrimit të juridiksionit tatimor ndërmjet dy shteteve. Konkretisht, në nenin 15 të Konventës së nënshkruar mes shtetit shqiptar dhe atij holandez, ratifikuar me ligjin nr. 9382, datë 04.05.2005, përcaktohet se: “[...] rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga punësimi do të taten vetëm në atë shtet përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna është ushtruar në këtë mënyrë, këto të ardhura të realizuara në këtë mënyrë, mund të taten në këtë shtet tjetër”. Në këto kushte, përkundër nga sa ka pretenduar subjekti, lidhur me pagesën e tatimit në shtetin e origjinës, dhe shmangien e tatimit të dyfishtë, i parashikuar në konventat ndërkombëtare, trupi gjykues vëren se, në çdo rast, subjekti në lidhje me të ardhurat e pretenduara për periudhën pas kësaj date, mbartte detyrimin të provonte pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat e realizuara nga bashkëshortja e tij. Ndërsa, lidhur me të ardhurat e realizuara nga znj. M., përpara ratifikimit të kësaj Konvente, subjekti duhet të provonte pagesën e tatimeve në vendin e origjinës, në këndvështrim të nenit 37 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe, vetëm në këtë mënyrë do të mund të legjitimonte pretendimin e tij mbi shmangien e taksimit të dyfishtë. Lidhur me këtë të fundit, në pikën 2, shkronja “a”, të nenit 23 të Konventës së përshkruar më sipër, përcaktohet se: “Kur një rezident i Shqipërisë realizon të ardhura ose zotëron kapitale të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente mund të taten në Holandë, Shqipëria do të lejojë: i) një reduktim nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguar në Holandë; dhe ii) një reduktim nga tatimi shqiptar mbi kapitalin e atij rezidenti, të një shume të barabartë me tatimin mbi kapitalin të paguar në Holandë. Megjithatë, në asnjë rast ky reduktim nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat apo mbi kapitalin të llogaritur para dhënies së reduktimit, që i atribuohet, sipas rastit, të ardhurave apo kapitalit që mund të taten në Holandë”.

45.6. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues shqyrtoi edhe pretendimin e subjektit, se është në pamundësi për të provuar se punëdhënësi ka shlyer detyrimet tatimore, për shkak të kohës së largët që ka kaluar. Këtë pretendim subjekti e ka argumentuar duke u shprehur në ankim se: “V. M. ka bërë tërë përpjekjet dhe ka gjetur tërë dokumentet e mundshme për rastin e vet. Këtu duhet pasur parasysh që fondacioni holandez është mbyllur dhe nuk ka më asnjë mundësi që të kërkojmë të dhëna ose të marrim dokumente të tjera në një vend pas shumë vitesh”. Ndërsa në parashtrimet e dërguara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka referuar se: “... sa kam pretenduar në ankim për pamundësinë e organeve shtetërore që të japin një tablo të qartë të regjistrimit të saj në ISSh, në organet tatimore, dhe të pagesave të kontributeve të bashkëshortes ndër vite, qëndrojnë plotësisht. Sërish i qëndroj mendimit tim që përgjigjet e cunguara nga Drejtoria Rajonale Tatimore nuk mund të jenë “mbretëreshë e provave” dhe të merren të mirëqena. Vlera e tyre duhet parë në përputhje me tërë provat e tjera shkresore, duke përfshirë dhe deklaratimet tona si dhe duhen vlerësuar sipas një logjike veprimi dhe logjikës së ligjeve në fuqi në periudhën në fjalë. Ky lloj hetimi administrativ nuk mund të provonte dhe nuk mund të prodhonte rezultate njëqind për qind të vërteta, të besueshme, për vetë faktin që arkivat e institucioneve shqiptare nuk janë plotësisht të besueshme”.

45.7. Trupi gjykues vëren se pretendimi i mësipërm është superuar tashmë nga zbatimi i ligjit nr. 84/2016, i cili ka përcaktuar në themel të tij barrën e provës për subjektin, për të provuar

deklarimet në kuadër të këtij procesi, përtej parashikimeve të tjera ligjore që kanë rregulluar marrëdhënie të ndryshme në kohë. Në këtë optikë, thirrja për zbatim e nenit 32, pika 2, të këtij ligjit, për shkak të pamundësisë së subjektit për të provuar se “*punëdhënësi ka shlyer detyrimet*”, vlerësohet si një artificë për t’u zhveshur nga përgjegjësia/barra e provës që ka në funksion të këtij procesi, për të provuar pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara prej bashkëshortes së tij. Për më tepër, znj. M. ka zgjedhur me vullnetin e saj, të mos i nënshtrohet një regjimi të qartë ligjor që do të dokumentonte të ardhurat e saj si përfaqësuese/konsulente, sikurse rezultoi e provuar përmes akteve të paraqitura prej vetë subjektit, në të cilat parashikohet shprehimisht se detyrimi për pagesën e tatimeve i takonte përfaqësuesit lokal/individit palë në marrëveshje, pra personit të lidhur. Në këto kushte, trupi gjykues krijoi bindjen se personi i lidhur ka pasur dijeni të plotë për mungesën e pagimit të detyrimit tatimor dhe është pajtuar me këtë situatë gjatë marrëdhënies me fondacionin “{***}”. Për shkak të kësaj qasjeje, që duket se ka lejuar personin e lidhur të subjektit të përfitojë të ardhura të konsiderueshme pa paguar detyrimet tatimore, trupi gjykues e gjen të padrejtë aplikimin e nenit 32, pika 2, i cili tipikisht zhvesh nga përgjegjësia ata që kanë qenë në mirëbesim, kanë ditur ose prezumohet për shkak të rrethanave që kanë besuar se detyrimet tatimore kanë qenë paguar, por kjo nuk mund të provohet për fakte që nuk varen prej tyre. Rrjedhimisht, edhe për shkak të kësaj analize, krahas asaj që lidhet me dijeninë /ndërgjegjësimin për mospagimin e detyrimeve tatimore, të analizuar më lart, trupi gjykues bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, vlerësoi se personi i lidhur ka vepruar në keqbesim në drejtim të mos deklaramit të të ardhurave të përfituara dhe mos pagimit të detyrimeve tatimore lidhur me to³¹.

45.8. *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se personi i lidhur nuk ka pasur detyrimin ligjor për deklarimin e të ardhurave, për sa kohë të ardhurat vjetore nuk tejkalonin kufirin prej 2 milionë lekësh, si dhe se deklarimi individual i të ardhurave ka filluar të zbatohet nga viti 2011, trupi gjykues vlerëson se ky qëndrim nuk gjen mbështetje në kuadrin ligjor tatimor në fuqi në periudhën përkatëse dhe nuk mund të shërbejë si argument për të përjashtuar mungesën e dokumentimit të të ardhurave të pretenduara pasi, deklarimi individual i të ardhurave përbën një nga elementet e formalizimit fiskal të të ardhurave, krahas detyrimit për pagesën e tatimit mbi të ardhurat. Në interpretim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, rezulton se ndryshe nga sa ka pretenduar subjekti, detyrimi për deklarimin e të ardhurave individuale ka qenë i parashikuar në mënyrë të qartë edhe përpara vitit 2011. Në zbatim të kuadrit të mësipërm ligjor, deklarimi i të ardhurave realizohej përmes procedurave administrative pranë organit tatimor kompetent, ku subjektet përkatëse paraqiteshin fizikisht për të tërhequr formularët standardë të deklarimit dhe për të depozituar deklaratat përkatëse. Në vijim, me ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010 (i cili ka hyrë në fuqi në datën 1 janar të vitit 2011), për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, u përcaktua pragu prej 2 milionë lekësh³², i cili*

³¹ *Shih vendimet e Kolegjit nr. 5/2023 (JR), datë 21.02.2023, dhe nr. 15/2021 (JR), datë 18.06.2021.*

³² *Në nenin 4 të këtij ligji përcaktohej se neni 13, ndryshohet si më poshtë:*

1. Tatimpaguesit individë rezidentë apo të vetëpunësuarit rezidentë, sipas nenit 12 të këtij ligji, që realizojnë të ardhura në territorin e Republikës së Shqipërisë, dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi. 2. Përjashtohen nga detyrimi për plotësim të deklaratës vjetore të të ardhurave: a) tatimpaguesit individë, të cilët gjatë një viti realizojnë të ardhura vjetore jo më shumë se 200 000 lekë; b)

lidhej me detyrimin për paraqitjen e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave, në kuptimin procedural të administrimit fiskal, por jo me mungesën e detyrimeve apo me përjashtimin nga përgjegjësia për deklarim të personave fizikë apo natyror që realizonin të ardhura nën këtë prag. Me zhvillimet administrative të mëvonshme (në vitin 2013), është bërë kalimi në sistemin elektronik të deklarimit tatimor, duke modernizuar mënyrën e administrimit të të dhënave fiskale, pa cenuar apo krijuar për herë të parë vetë detyrimin ligjor për deklarim. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se detyrimi për deklarimin e të ardhurave mbi 2 milionë lekë u vendos në vitin 2011, gjendet i pambështetur në ligj.

46. Në përfundim të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur bazuar në marrëveshjet e nënshkruara mes saj dhe fondacionit “{***}”, trupi gjykues konstatoi se shuma totale për të cilat personi i lidhur kishte drejtpërdrejt përgjegjësinë për pagesën e detyrimeve tatimore, referuar përcaktimeve në marrëveshje, rezultoi në vlerën 6.355.857 lekë. Ndërsa, për periudhat 2000 – 2002 dhe prill – dhjetor të vitit 2007, për të cilat nuk u provua me dokumentacion marrëdhënia e punësimit apo se kujt i takonte përgjegjësia për pagesën e detyrimeve tatimore, të ardhurat rezultuan në vlerën 2.281.964 lekë.
47. Në dritën e sa më sipër, pavarësisht se rezultuan akte dhe indicie se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, gjatë periudhës 2000–2009, ka përfituar të ardhura sipas kontratave/marrëveshjeve përkatëse me fondacionin “{***}”, trupi gjykues vlerësoi se ato nuk plotësojnë kërkesat e nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, dhe si rrjedhojë, nuk mund të përfshihen në analizën financiare të subjektit dhe personit të lidhur, si burime të cilat janë përdorur për krijimin e depozitave, për sa kohë mungon konfirmimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e krijuara.

b)/2 Të ardhurat e personit të lidhur nga veprimtari si përkthime, konsulenca apo ekspertiza, të kryera për palë të treta, si OJF dhe subjekte të ndryshme tregtare

48. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, subjekti ka deklaruar si burim për krijimin e depozitave bankare të tij dhe bashkëshortes, të ardhurat nga veprimtari të ndryshme, si përkthime, konsulenca, ekspertiza etj., të ofruara nga bashkëshortja e tij, ndaj personave juridikë të regjistruar ose jo në Shqipëri. Këto depozita, të deklaruara nga subjekti në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe në deklaratat periodike vjetore janë përdorur për likuidimin e çmimit të pasurisë “apartament” në Tiranë.
49. Lidhur me këto të ardhura, sikurse është pasqyruar më sipër në këtë vendim, Komisioni ka konkluduar se, edhe pse rrjedhin nga burime të ligjshme, ato nuk përmbushin kërkesat e nenit D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk u provua pagesa e detyrimit tatimor, e për rrjedhojë, nuk i ka përfshirë ato në analizën financiare të kryer për subjektin dhe personin e lidhur.
50. Për të provuar ekzistencën e këtyre të ardhurave, subjekti ka paraqitur kontrata apo marrëveshje angazhimi, dokumentacion bankar për kalimin e shumave në llogaritë e bashkëshortes, si dhe

tatimpaguesit që janë të vetëpunësuar e që kanë një qarkullim vjetor deri në 2 000 000 lekë; c) të gjithë taksapaguesit, të cilët gjatë një viti realizojnë të ardhura vetëm nga paga dhe për të cilat punëdhënësi i ka paguar taksat në burim, të ardhura nga pensioni apo të ardhura nga vetëpunësimi për të cilat i kanë paguar taksat.

në disa raste është mbështetur vetëm në deklarinimin periodik të këtyre të ardhurave, të cilat analizohen në vijim.

(i) *Për të ardhurat nga projekti DSO nga shërbimi në kuadër të DSO (Privatisation of the Distribution System Operation – KESH) / I. H., viti 2008, në shumën 8.000 euro*

50.1. Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar; “*Të ardhura nga shërbimi në kuadër të DSO (Privatisation of the Distribution System Operation - KESH); deklaruar për vitin 2008. (transferta bankare përmes Raiffeisen Bank). Bashkëlidhur “task description” për V. M. si Project assistant, lëshuar nga I. H. si dhe konfirmim pagimi*”. Në shumën 8.000 euro.

50.2. Në DIPP-në e vitit 2008, këto të ardhura janë deklaruar dhe nga subjekti i rivlerësimit. Për të provuar këto të ardhura, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) dokument për përshkrimin e punës “*Task Description*”, i cili përshkruan shërbimin e ofruar nga bashkëshortja e subjektit gjatë periudhës 01.05.2008 deri më 31.08.2008. Dokumenti është nënshkruar ndërmjet saj dhe z. I. H. Sipas marrëveshjes, bashkëshortja e subjektit do të përfitonte një shumë totale prej 8.000 eurosh, e ndarë në katër pagesa mujore prej 2.000 eurosh secila; (ii) dokument për konfirmimin e pagesës, “*Confirmation of Payment*”, nënshkruar nga personi i lidhur, e cila konfirmon përfitimin e shumës, prej 8.000 eurosh, nga z. I. H., në kuadër të angazhimit të saj në këtë projekt, për periudhën maj – gusht 2008. Me prapësimet e tij pas rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit ka paraqitur gjithashtu një deklaratë noteriale³³ të lëshuar nga z. I. H., me anë të së cilës ai deklaroi se ka ushtruar funksionin e konsulentit në një kompani me qendër në Austri, dhe se, për nevojat e projektit, bashkëshortja e subjektit ka kryer shërbimet e kërkuara për të cilat është paguar sipas shumës së parashikuar në marrëveshje. Gjithashtu, z. I. H. deklaroi se të ardhurat e tij janë deklaruar në Austri, sipas ligjit të taksave të atij shteti.

50.3. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar, konfirmohet se në datë 25.08.2008, në llogarinë bankare të personit të lidhur, pranë Raiffeisen Bank ShA, është kryer një transfertë bankare në shumën 8.000 euro, me urdhërues “*Dipl. Ing. I. H.*” dhe përshkrim “*May till August – Projekt DSO*”.

(ii) *Për të ardhurat nga kompania “{***}”, viti 2009, në shumën 2.392 euro*³⁴

50.4. Në deklaratën *vetting* personi i lidhur ka deklaruar: “*Të ardhura nga Brantner për projektin Menaxhimi i mbetjeve në Tiranë; transferta bankare përmes Raiffeisen Bank, më 23.10.2009 (referohu statement-it bankar). Nuk kam gjetur dokumente provues*”. Shuma e deklaruar: 2.392,75 euro. Në DIPP-në e vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat nga kjo kompani në shumën 2.500 euro.

50.5. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar në dosje, konfirmohet se në datën 23.10.2009, në llogarinë e personit të lidhur në Raiffeisen Bank ShA, është kredituar nëpërmjet transfertës vlera 2.392 euro, me urdhërues “{***}”, me përshkrimin: “*Pay015 Invoice from 12 June 2009*”.

³³ *Deklaratë noteriale e z. I. H., nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.10.2023.*

³⁴ *Në datën 23.10.2009, në Raiffeisen Bank është kredituar shuma 2.392 euro, me urdhërues “{***}”, në Austri, me përshkrim: “Invoice from 12 June 2009”.*

(iii) Për të ardhurat nga kompania “{***}”, projekti “Hot Spot”, të përfituara në datën 28.01.2009, në shumën 1.061 euro

50.6. Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar: “Të ardhura nga {***}, projekti Hot Spot; bashkëlidhur mandat pagesa nr. {***}, datë 28.01.2009”. Në shumën 1.060 euro. Të njëjtin deklaram ka bërë dhe subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2009.

50.7. Për të provuar këto të ardhura, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si dokument justifikues, mandat pagesën nr. {***}, datë 28.01.2009, i vulosur nga kompania {***}. Nga përmbajtja e këtij mandati, u konstatua se personi i lidhur ka përfituar shumën prej 1.060 eurosh për shërbime konsulence për projektin “Hot Spot”. Me prapësimet e dërguara pas njoftimit të rezultateve të hetimit nga Komisioni, subjekti ka paraqitur edhe një deklaratë noteriale³⁵ të lëshuar nga z. A. V., i cili, në cilësinë e drejtuesit të ekipit lokal të kompanisë në fjalë, ka deklaruar se V. M. ka përfituar shumën prej 1.060 eurosh për shërbimet e kryera sipas marrëveshjes, si dhe ka konfirmuar se kjo shumë ka qenë e tatuar, ndaj vlera e pasqyruar në mandatin nr. {***}, datë 28.01.2009, përfaqëson shumën neto.

(iv) Për të ardhurat nga shoqëria “{***}”, në vitin 2007, në shumën 3.250 euro³⁶

50.8. Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar: “Të ardhura nga {***}, viti 2007. Referenca {***}, Progress Monitoring for Countries of South-East Europe. Pagesat janë bërë përmes Raiffeisen Bank (referohu statement-it). Kontratë nuk posedoj. Bashkëlidhur printim komunikimi me personin përgjegjës dhe kërkesa për pagesa”. Shuma e deklaruar është 3.250 euro. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shumën prej 3.300 eurosh të përfituar nga bashkëshortja e tij si monitoruese në këtë projekt.

Për të provuar këto të ardhura, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) “Payment of fee for period December 2006 – April 2007” dhe (ii) “Payment of fee for period April – July 2007”, të cilat konfirmojnë se personi i lidhur ka përfituar nga kompania “{***}” në total shumën prej 3.267 eurosh, për punë të kryer në kuadër të projektit “Progress monitoring for the countries of South-Eastern Europe DG ENV”. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar, rezulton se: më datë 26.06.2007, në llogarinë bankare të personit të lidhur në Raiffeisen Bank është kredituar shuma prej 971,80 eurosh, përmes një transfertë nga subjekti dërgues “{***}”, me përshkrim “EUR 980/COWI/INVOCE NO. 01”; si dhe më datë 14.09.2007, po në këtë llogari është kredituar shuma prej 2.278,97 eurosh, nga e njëjta kompani, me përshkrimin: “EUR 2.287,00/COWI/INVOCE NO. 02”. Në total, nëpërmjet bankës, janë përfituar 3.251 euro.

(v) Për të ardhurat nga kontrata e konsulencës me shoqërinë “{***}”, për vitin 2011, në shumën 1.900 euro

50.9. Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar: “Të ardhura nga kontratë konsulence me kompaninë {***}, datë 12.01.2011, për punë në lidhje me landfill-in e Durrësit; pagesa

³⁵ Deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.11.2023.

³⁶ Më datë 26.06.2007, në Raiffeisen Bank është kredituar shuma prej 971 eurosh, përmes një transfertë nga subjekti dërgues “{***}”; si dhe më datë 14.09.2007, po në këtë llogari është kredituar shuma prej 2.279 eurosh.

përmes Intesa Sanpaolo Bank. Bashkëlidhur kontrata, si dhe tre invoice.” Shuma e deklaruar është 1.900 euro.

50.10. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka përfituar pagesë nga kjo kompani për punën e kryer, në shumën 1.450 euro.

50.11. Për të provuar këto të ardhura, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) marrëveshjen “*Consultant Agreement*”, datë 12.01.2011, të lidhur ndërmjet bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të “{***}”, në të cilën përcaktohet shpërblimi prej 25 euro/orë për 8 orë pune në ditë si dhe detyrimi i konsulentit për deklarimin dhe pagesën e çdo detyrimi tatimor sipas legjislacionit në fuqi; (ii) faturën “*Invoice nr. {***}*”, datë 03.05.2011, për 32 orë pune në vlerën 800 euro; (iii) faturën “*Invoice*” pa numër, datë 31.05.2011, për 22 orë pune në vlerën 550 euro; dhe (iv) faturën “*Invoice nr. {***}*”, datë 06.06.2011, për 22 orë pune në vlerën 550 euro.

50.12. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar konfirmohet se, më datë 22.06.2011, në llogarinë e personit të lidhur pranë Intesa SanPaolo Bank, është transferuar shuma prej 550 eurosh, me dërgues të paidentifikuar dhe pa përshkrim specifik. Nuk identifikohen transaksione bankare të tjera.

(vi) *Për të ardhurat nga konsulenca për shoqërinë “{***}”, në vitet 2012 – 2014, shuma 11.979 euro*

50.13. Në deklaratën *vetting* personi i lidhur ka deklaruar: “*Të ardhura nga konsulencë për {***}. Bashkëlidhur kontrata pagesat përmes Raiffeisen Bank (referohu printimit të statement-it bankar).*” Shuma e deklaruar është 11.979 euro.

50.14. Në DIPP-në e vitit 2012, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga konsulenca në mënyrë të grupuar për disa kompani, çka pamundëson identifikimin e veçantë të shumës së përfituar nga shoqëria “{***}”. Në DIPP-në e vitit 2013, nuk rezultojnë deklarime të të ardhurave nga kjo marrëdhënie. Ndërsa në DIPP-në e vitit 2014, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga konsulenca me kompaninë “{***}” në shumën 84.000 lekë.

50.15. Për të provuar këto të ardhura, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur “*Marrëveshje për konsulencë afatshkurtër*”, datë 07.03.2012, të lidhur ndërmjet bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të shoqërisë “{***}”, në të cilin palët kanë dakordësuar që personi i lidhur, për kryerjen e shërbimeve të konsulencës, kundrejt një përfitimi në shumën totale prej 12.000 eurosh, të ndarë në 120 ditë pune me tarifë 100 euro në ditë. Në këtë marrëveshje përcaktohet gjithashtu, se pagesa e detyrimeve tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore, dhe pensionet sociale në vendin e rezidencës, mbetet përgjegjësi e plotë e konsulentit.

50.16. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar rezulton se, në periudhën 21.06.2012 – 26.06.2014, në llogarinë e personit të lidhur pranë Raiffeisen Bank, janë kryer shtatë transfertat nga kompania “{***}”, me një vlerë totale prej 11.979 eurosh, me përshkrime që i referohen likuidimit të faturave mujore dhe periudhave përkatëse të shërbimeve të kryera.

(vii) Për të ardhurat nga kontrata e datës 22.06.2016 me shoqërinë “{***}” KG³⁷, në shumën 9.753 euro, për projektin “ECRAN” i BE-së

50.17. Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar: “Të ardhura nga kontrata me {***} ({***}, {***} Vienna, Austria, HR Wien {***}, z. UID ATU {***}), projekti ECRAN i BE-së. Bashkëlidhur kopje e kontratës datë 22.02.2016, Mission ToR, disa invoice; pagesat me bankë, kryer në tre këste më: 01.07.2016, 31.08.2016, 18.10.2016.” Shuma e deklaruar është 9.753 euro. Në DIPP-në e vitit 2016, personi i lidhur ka deklaruar të njëjtën shumë të përfituar nga kjo kompani. Për të provuar këto të ardhura, bashkëlidhur deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) Kontratë shërbimi lidhur në datën 22.02.2016, midis bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të kompanisë “{***}” KG. Sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje, personi i lidhur do të përfitonte 140 euro në ditë për shërbimet e kryera. Në këtë marrëveshje është parashikuar gjithashtu se eksperti, që në këtë rast është personi i lidhur, është përgjegjës për pagimin e taksave që lidhen me këtë të ardhur; (ii) faturë nr. {***}, e datës 01.06.2016, ku evidentohet pagesa në shumën 2.100 euro, e përlllogaritur mbi bazën e tarifës prej 140 eurosh në ditë për 15 ditë pune; (iii) faturë nr. {***} e datës 25.07.2016, ku evidentohet pagesa në shumën 3.500 euro, e përlllogaritur mbi bazën e tarifës prej 140 eurosh në ditë për 25 ditë pune.

50.18. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar të administruar, rezulton se në llogarinë bankare të personit të lidhur pranë Raiffeisen Bank, janë kryer disa transaksione nga shoqëria “{***}”, konkretisht: (i) më 01.07.2016, është depozituar shuma 2.100 euro me përshkrimin “{***}”; (ii) më 31.08.2016, është transferuar shuma 3.459 euro me përshkrimin “{***}”; dhe (iii) më 18.10.2016, është depozituar shuma 4.194 euro me përshkrimin “FEES JULY SEPTEMBER/{***}”. Në total, vlera e këtyre transfertave të realizuara në llogarinë e personit të lidhur, arrin në 9.753 euro.

(viii) Për të ardhurat nga organizata ndërkombëtare “{***}”, në vitin 2004, në shumën 71.385 lekë: Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur ka deklaruar të ardhura nga përkthime materialesh për shoqata, në shumën 71.385 lekësh dhe se nuk ka kontratë dhe as mandat pagesë. I njëjti deklaram është kryer dhe nga subjekti në DIPP-në e vitit 2004.

(ix) Për të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga shoqata “{***}”, viti 2004, nuk rezulton të jenë deklaruar as në deklaratën *vetting* dhe as në vitin 2004. Për këto të ardhura nuk rezulton të ketë ndonjë dokumentacion provues apo transaksion bankar.

(x) Për të ardhurat nga shoqata “{***}”, për vitet 2004, 2006, shuma 60 USD ose 7.422 lekë: Këto të ardhura janë deklaruar në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore. Për të vërtetuar këto të ardhura, subjekti ka paraqitur një mandat pagesë, i cili nuk është i lexueshëm.

³⁷ Subjekti ka paraqitur: Dokument “Services agreement”, datë 22.02.2016, nënshkruar mes bashkëshortes së subjektit dhe përfaqësuesit të “{***}”, për kryerjen e shërbimeve të përcaktuara në këtë dokument personi i lidhur do të përfitonte shumën prej 140 euro / ditë; “Invoice nr. {***}”, datë 01.06.2016, ku është përcaktuar një pagesë prej 2.100 eurosh, 140 euro / ditë * 15 ditë pune; “Invoice nr. {***}”, datë 25.07.2016, ku është përcaktuar një pagesë prej 3.500 eurosh, 140 euro / ditë * 25 ditë pune. Në Raiffeisen Bank janë identifikuar këto transaksione me dërgues “{***}”: Më 01.07.2016, është depozituar shuma prej 2.100 eurosh; Më 31.08.2016, është transferuar shuma prej 3.459 eurosh; Më 18.10.2016, është depozituar shuma prej 4.194 eurosh. Në total, vlera e transferimeve të realizuara në llogarinë e personit të lidhur arrin në 9.753 euro.

Në dosje nuk gjendet ndonjë dokument shtesë që të konfirmojë pagesën e detyrimeve tatimore apo përfitimin e këtyre të ardhurave.

(xi) *Të ardhurat nga “{***}”³⁸, viti 2014, në shumën 107.222 lekë. Këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratën vetting dhe as në atë të vitit 2014. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, rezulton se në llogarinë e personit të lidhur pranë ISP Bank, gjatë vitit 2014 është kredituar cash shuma prej 107.222 lekë, me përshkrimin: “Cash deposit E. M., pagesë nga {***}”. Nga verifikimi i akteve në dosje, nuk rezulton të jetë paraqitur dokumentacion për të provuar marrëdhënien e punës/shërbimit apo pagesën e detyrimeve tatimore.*

51. Në kushtet kur subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor (kontrata apo marrëveshje angazhimi), marrëdhënien e shërbimit që kishte gjeneruar të ardhurat e pretenduara, si dhe ligjshmërinë e tyre, ndonëse në zbatim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 19, dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, si dhe ekzistencën e marrëdhënies së punës apo të kryerjes së shërbimeve përkatëse në drejtim të pagesës së detyrimeve tatimore, subjekti është mjaftuar vetëm në deklarimin e këtyre të ardhurave në deklaratat periodike.

52. Subjekti ka pretenduar se të ardhurat e personit të lidhur burojnë nga marrëdhënie kontraktore të ligjshme dhe se të ardhurat janë administruar nëpërmjet sistemit bankar dhe janë deklaruar rregullisht. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se detyrimi për pagesën e tatimeve i përket punëdhënësit ose kontraktuesit, dhe jo përfituesit të të ardhurave. Sipas subjektit, mungesa e dokumentacionit lidhet me faktorë objektivë dhe nuk mund të interpretohet në disfavor të tij apo të konsiderohet provë e mospagimit të detyrimeve tatimore.

52.1. Në analizë të pretendimit të subjektit *se të ardhurat burojnë nga marrëdhënie kontraktore të ligjshme*, nga analiza e akteve në fashikujt e Komisionit, trupi gjykues konstatoi se ushtrimi i veprimtarisë nga znj. M. në formën e konsulencave apo përkthimit, duket se është bërë kryesisht nëpërmjet marrëdhënies së shërbimit, të dakordësuar ndërmjet saj si individ dhe marrësve të shërbimit, të cilët kanë qenë shoqëri apo organizata jofitimprurëse ndërkombëtare, të regjistruara ose jo në Shqipëri. Megjithatë, sikurse u pasqyrua në mënyrë të detajuar më sipër, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor (marrëveshje apo kontrata), për të gjitha periudhat për të cilat pretendohen të jenë përfituar të ardhurat, për të analizuar të drejtat dhe detyrimet reciproke të palëve, përfshirë dhe atë për pagimin e detyrimeve tatimore, për rrjedhojë trupi gjykues vlerësoi si të pabazuar pretendimin e subjekti i rivlerësimit se këto marrëdhënie provohen nga deklarimet e tij në deklarimet periodike të interesave pasurorë. Mosparaqitja e këtij dokumentacioni, pasjell vlerësimin e ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, bazuar në legjislacionin në fuqi të kohës³⁹.

52.2. Në lidhje me pretendimin e subjektit se të ardhurat janë administruar nëpërmjet sistemit bankar dhe janë deklaruar rregullisht, trupi gjykues vlerëson se referuar nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka barrën për të provuar jo vetëm ekzistencën e një transaksioni financiar, por edhe burimin e ligjshëm, si dhe ligjshmërinë e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë. Në këtë kuptim, mënyra e kryerjes së pagesës, qoftë edhe

³⁸ Nga dokumentacioni bankar ku pasqyrohet kreditimi i shumës së përfituar, nuk identifikohet emri tregtar i këtij subjekti.

³⁹ Vlerësim i kryer në vijim të këtij vendimi nga trupi gjykues.

nëpërmjet bankës, nuk është element i mjaftueshëm për të legjitimuar të ardhurat e përfituara, pasi procesi i rivlerësimit nuk ka për objekt vetëm verifikimin formal të ekzistencës së transaksioneve, por kontrollin substancial të burimit të pasurisë dhe të ligjshmërisë së saj.

52.3. Në këtë drejtim, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë kryer transfertat bankare nga llogaritë në të cilat pretendohet se arkëtohen të ardhurat, drejt llogarive dyemërore të përdorura për akumulimin e shumave që shërbyen si burim krijimi për pasurinë apartament. Nga analiza e dokumentacionit bankar, rezulton se subjekti dhe personi i lidhur kanë kryer kryesisht depozitime *cash* në këto llogari, duke mos krijuar një rrjedhë të qartë dhe të gjurmueshme financiare ndërmjet të ardhurave të pretenduara dhe fondeve të përdorura për krijimin e pasurisë. Për pasojë, pretendimi se vetë fakti i kryerjes së pagesave nëpërmjet sistemit bankar provon ligjshmërinë e të ardhurave, nuk gjen mbështetje në standardet kushtetuese dhe në jurisprudencën e Kolegjit⁴⁰.

52.4. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se detyrimi për pagesën e tatimeve i përkiste punëdhënësit ose kontraktuesit, dhe jo përfituesit të të ardhurave, dhe se mungesa e dokumentacionit lidhet me faktorë objektivë dhe nuk mund të interpretohet në disfavor të tij apo të konsiderohet provë e mospagimit të detyrimeve tatimore. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti ka referuar shkresën e DPT-së⁴¹, në të cilën sqarohet se, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, llogaritja, mbajtja dhe pagesa e detyrimit tatimor kryhen, në parim, nga tatimpaguesi që realizon pagesën dhe është i regjistruar në administratën tatimore në Republikën e Shqipërisë.

52.5. Në vijim të analizës së kryer më sipër, në lidhje me të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur sipas marrëveshjeve të nënshkruara me fondacionin “{***}”, trupi gjykues vëren se ligji i kohës, me nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, përcaktojnë qartësisht detyrimin për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e siguruara nga shërbimet individuale. Po ashtu, ky ligj, linte në vlerësimin/zgjedhjen e ofruesit të shërbimit, nëse ai do të realizohet nëpërmjet një subjekti tregtar/personi fizik të regjistruar prej tyre, sipas legjislacionit në fuqi apo si individ në marrëdhënie shërbimi me porositësit e tij. Në të dy format e ushtrimit të veprimtarisë profesionale të konsulencës apo shërbimit të përkthimit, për të ardhurat e përfituara duhet të paguhej detyrimi tatimor⁴², por subjekti që mban dhe paguan atë, është i ndryshëm. Duket se edhe në këto shërbime të ofruara, bashkëshortja e subjektit, znj. M. ka zgjedhur të mos regjistrohet si subjekt tregtar apo të deklarojë pranë tatimeve të ardhurat e përfituara⁴³, të cilat më tej mund të ishin objekt kontrolli/vlerësimi nga organet tatimore sa i përket pagimit të detyrimeve përkatëse. Në këtë këndvështrim, edhe në lidhje me shkresën e sipër përshkruar, të paraqitur nga subjekti në mbështetje të pretendimeve

⁴⁰ Shih vendimin nr. 5, datë 21.02.2023, të Kolegjit.

⁴¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 15.11.2023, në të cilën citohet se: “Të ardhurat personale të përfituara nga shoqëritë jorezidente në Republikën e Shqipërisë, “{***}” (rezidente në Holandë), {***}, {***}, {***}, {***}” (rezidente në Austri), {***} (rezidente në Danimarkë), {***} (rezidente në Austri), nuk i nënshtrohen dispozitave të ligjit 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

⁴² Nenet 6 dhe 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, parashikojnë se tatimi mbi të ardhurat personale llogaritet mbi të ardhurat e individëve, me burim në Republikën e Shqipërisë.

⁴³ Sipas legjislacionit për tatimin mbi të ardhurat, si më sipër referuar në vendim.

të tij, trupi gjykues e konsideron të pabazuar pretendimin e subjektit lidhur me përgjegjësinë për përmbushjen e detyrimeve tatimore nga personi i lidhur.

52.6. Në përfundim, të ardhurat e pretenduara më sipër, të krijuara nga bashkëshortja e subjektit nga veprimtari të ndryshme si përkthime, konsulenca dhe ekspertiza, kryesisht në sektorin e OJF-ve, nuk mund të përfshihen në analizën financiare si burime të ligjshme për krijimin e depozitave bankare, të përdorura më pas për blerjen e apartamentit në vitin 2010, në të gjitha rastet kur për to mungon dokumentacioni justifikues ligjor i kryerjes së shërbimit, si dhe mungon konfirmimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e krijuara. Në këto kushte, referuar në sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit për këto të ardhura, për të cilat ai nuk ka arritur të provojë ligjshmërinë e tyre, nuk do të konsiderohen si të ardhura, të cilat plotësojnë kriteret e nenit D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016 ndaj, me të drejtë, Komisioni nuk i ka përfshirë këto të ardhura në analizën financiare.

53. Në eventualitetin e këtyre fakteve, si dhe në konsideratë të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të shpjegojë bindshëm jo vetëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive, por edhe të të ardhurave të përfituara nga personi i lidhur/bashkëshortja. Nën dritën e këtij parashikimi kushtetues, si dhe mbështetur në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit për raste të ngjashme⁴⁴, standardi i vendosur nga kjo dispozitë, për përcaktimin e ligjshmërisë së të ardhurave, kërkon që ato të jenë krijuar nga burime të ligjshme, të jenë deklaruar, si dhe për to të jenë paguar detyrimet tatimore përkatëse.
54. Për sa u analizua më sipër, nga dokumentacioni i administruar rezulton se të ardhurat e pretenduara të krijuara nga bashkëshortja e subjektit nga veprimtari të ndryshme, si përkthime, konsulenca dhe ekspertiza, kryesisht në sektorin e OJF-ve, në total arrijnë në shumën 6.730.396 lekë, nga të cilat 969.118 lekë nuk shoqërohen me kontrata justifikuese, 3.259.702 lekë (për të cilat në kontrata është përcaktuar shprehimisht se detyrimi për pagesën e tatimeve është në ngarkim të bashkëshortes së subjektit) dhe 2.501.576 lekë (për të cilat nuk rezulton e përcaktuar se cila palë ka detyrimin për pagesën e detyrimeve tatimore). Në përfundim, lidhur me këto të ardhura, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur dështuan të provojnë ligjshmërinë e tyre, si rrjedhojë e mospagimit të detyrimeve tatimore, në kundërshtim të përcaktimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19, të ligjit nr. 84/2016.

c) Lidhur me të ardhurat e dhuruara nga babai i subjektit të rivlerësimit, i ndjeri H. M., në shumën 5.000.000 lekë

55. Komisioni ka konkluduar se: “Subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016 nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur për të mundësuar lënien/dhurimin e shumës 5,000,000 lekë në favor të tij”. Në arritjen e këtij konkluzioni, Komisioni ka arsyetuar se: “...babai i subjektit nuk është kategorizuar në cilësinë e personit të lidhur, por në cilësinë e personit tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit në përputhje me përkufizimin e bërë në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr.

⁴⁴ Shih vendimet e Kolegjit nr. 23/2020 (JR); nr. 6/2019 (JR); nr. 07/2019 (JR); nr. 19/2019 (JR) etj. <https://ikp.al/wp-content/uploads/2020/10/Bisedimet-p%3c%abrfundimtare-dat%3c%ab-3.2.2023.pdf>.

84/2016, për pasje në zbatim të nenit 32/4 të këtij ligji, dispozitë e cila ngarkon subjektin me barrën e provës për dokumentimin e të ardhurave të personave të tjerë të lidhur. Sa i përket pretendimit të subjektit se babai i tij ka ushtruar aktivitetin tregtar si ambulant dhe se në dukje pikërisht për këtë fakt nuk mund të disponojë të dhëna lidhur me këtë aktivitet, Komisioni vlerëson se pretendimet e tij mbeten të karakterit deklarativ. Vetë shkresa e Bashkisë Tiranë referon se nuk disponon të dhëna për ambulantët para vitit 2010, por jo se nuk disponon të dhëna për aktivitetin e babait të subjektit. Pra, në referim të kësaj shkrese nuk konfirmohet se babai i subjektit të ketë ushtruar aktivitetin e ambulantit dhe se bashkia nuk disponon të dhëna shtesë, rrethanë e cila mund të çonte në mënyrë hipotetike subjektin në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, vlera e pretenduar nga subjekti – në total në shumën 5,000,000 lekë, me burim fitimin nga aktiviteti tregtar i babait, në kushtet kur subjekti referon se ka pasur edhe mallra në sasi të konsiderueshme gjendje e të pashitura në momentin kur babai ka ndërruar jetë, duket se nuk është proporcionale me aktivitetin e ambulantit – duke vlerësuar se për të arritur në këtë vlerë të fituar (krahas të ardhurave të tjera që mund të jenë shpenzuar nga babai) do të duhej të realizohej një qarkullim në vlerë të konsiderueshme, që nuk i përgjigjet këtij lloj aktiviteti. gjithashtu, nga provat e administruara rezulton se në shkurt të vitit 2002, babai i subjektit është regjistruar si person fizik në gjykatë me qëllim ushtrimin e aktivitetit tregtar, por nga ana tjetër nuk rezulton të jetë regjistruar në organet tatimore”.

55.1. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratat e dorëzuara ndër vite pranë ILDKPKI-së rezultoi se: (i) Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: “Të holla (cash) të përfituara pas vdekjes së H. M., më 18.02.2008, në shumën 5.000.000 lekë. Nuk kam dokumente provues. Janë deklaruar si shumë në deklarin periodik, kam dhënë shpjegime dhe kam paraqitur dokumente të veprimtarisë tregtare të të ndjerit në vitin 2016, gjatë kontrollit tërësor të pasurisë së kryer nga ILDKPKI”; (ii) në DIPP-në e vitit 2008 në seksionin e pasurive, subjekti ka deklaruar: “Të holla (cash) të përfituara pas vdekjes së babait tim, H. M., më 18.02.2008. Burimi i krijimit: trashëgimia, dhurimi nga babai pak para vdekjes dhe përfitimi pas vdekjes”. Shuma 5.000.000 lekë; (iii) në DIPP- në e vitit 2009 në seksionin “ndryshimet e interesave private”: “Të holla (cash) të trashëguara nga im atë pas vdekjes, janë pakësuar gjatë vitit 2009”. Shuma 2.000.000 lekë; (iv) në deklaratat vijuese, subjekti/personi i lidhur nuk kanë deklaruar më pakësim të gjendjes *cash*.

55.2. Bashkëlidhur deklaratës *vetting*, ka paraqitur disa mandate, fletëhyrje, fletëdalje, urdhra dorëzimi dhe fletore/blloqe me shënime dore, që sipas subjektit janë të lidhura me aktivitetin tregtar të të ndjerit. Ndërsa, gjatë hetimit administrativ⁴⁵, në përgjigje të kërkesës së Komisionit, për të provuar dhe dokumentuar burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pagesën e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, subjekti ka paraqitur Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 20475, datë 12.02.2002, me objekt “Për regjistrimin e z. H. M. si person fizik”, ku përcaktohet se lënda e veprimtarisë së tij ishte “tregtimi i artikujve të ndryshëm industrialë si gozhdë, bulona etj.”.

55.3. I pyetur nga ILDKPKI-ja,⁴⁶ mbi krijimin e kësaj shume, deklaruar si likuiditet *cash* në DIPP 2008, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: “...babai është marrë me aktivitet privat, qysh prej vitit 1990, tek ish-uzina “{***}”. Ka patur një garazh afër hyrjes së

⁴⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

⁴⁶ Procesverbal i ILDKPKI-së, mbajtur më datë 02.06.2016.

uzinës, në të cilin mbante gjithë mallin. Garazhin e ka blerë 300.000 lekë, garazh i cili me vonë u prish, si ndërtim i paligjshëm. Pas kësaj, malli qëndroi në një ambient shtëpie, i një të njohurit tim, derisa u shit. Do të mundohem të gjej foto për sa pohoj, sepse mbaj mend që kam pas shkuar me gruan dhe fëmijët kur ai punonte dhe kemi bërë foto. Fotot i kemi bërë me celular dhe shpresoj të jenë ruajtur. Në vitin 2008, kur babai ka vdekur, në garazh malli i lënë ka qenë rreth 7.000.000 lekë, fakt të cilin e kam përmendur edhe kur kanë ardhur inspektorët e ILDKPKI-së, për trajnime në vitin në fjalë, për mënyrën e plotësimit të deklaratës. Malli u shit në vitet në vijim dhe shumicën e të ardhurave e ka marrë e veja e tim atë, e quajtur Z. M. Babai nuk ka mbajtur likuiditete në bankë, në dijeninë time dhe e kam të vështirë të provoj me dokumente ligjor, dhurimin nga ana e tij të likuiditetit në shumën 5.000.000 lekë”.

55.4. Lidhur me përfitimin e shumës 5.000.0000 lekë, mënyrën, momentin e marrjes në dorëzim, si dhe burimin e ligjshëm të saj, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se⁴⁷: “Për këtë çështje jam përgjigjur hollësisht në kontrollin periodik që është kryer nga ILDKPKI më 2016. Kam paraqitur asokohe origjinalet e tërë faturave që kam gjetur në garazhin ku im atë kryente veprimtarinë tregtare. Inspektori i ILDKPKI-së pasi i shqyrtoi tërë origjinalet, më kërkoi që të paraqisja fotokopjet. I kam fotokopjuar dhe i kam paraqitur në vijim aty... Faturat e gjetura, me sa kuptoj, u jepeshin klientëve të tij që ishin kryesisht nga rrethet e tjera, që kishin ndonjë sipërmarrje të vetën (prodhues divanesh, mobiliesh etj., - i mbaj mend këto nga bisedat me tim atë) dhe tregtarë që blinin tek ai dhe rishisnin mallrat në qytete të tjera. Ndërkaq, blerje më të vogla, më të shpeshta, nga klientë të tjerë që merrnin mallra sa për nevoja të tjera, nuk duhet të jenë shënuar nëpër fatura. Gjithsesi, në lidhje me sa pyetem, sqaroj që im atë, pasi u largua nga tregu i Pazarit të Ri, u vendos te tregu i Medresesë, që administrohej nga Bashkia e Tiranës. Besoj që, duke qenë tregtar ambulant aty në stendat e shitjeve të përcaktuara nga pushteti vendor, pagesat duhet të jenë bërë prej tij në favor të Bashkisë së Tiranës në kohën e kërkuar prej tyre. Pasi u largua nga tregu te Fusha e Medresesë, që kufizohej nga rruga “{***}” dhe rruga “{***}”, nisi të ushtronte veprimtarinë në hyrjen e ish-uzinës “{***}”, aty ku sot nis rruga “{***}” (adresën ku ushtronte veprimtarinë mund ta shikoni te disa prej faturave ku në krye të tyre shënohet adresa e punës)... Besoj që koha kur ka nisur ta ushtronte veprimtarinë në një vend të tillë duhet të jetë në vitin 2002, sepse te dokumentet që kam gjetur në garazhin e tij pas vdekjes, përveç faturave të shitjeve, kam gjetur dhe një “Vendim për regjistrimin si person fizik”, nr. {***}, datë 12.02.2002, i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, origjinal. Këtë vendim e kam skanuar dhe e paraqes. Duke iu referuar vendimit, shikohet dhe fusha e tregtimit “artikuj të ndryshëm industrial, gozhdë, bulona etj.”...Sa i përket vlerës 5.000.000 lekë, mund të konfirmoj që kam pasur të tillë vlerë në vitin 2008, pas vdekjes së tim etj., çka është deklaruar. Im atë nuk ka pushuar pothuajse asnjë ditë të jetës së tij, ka punuar deri afro 22 ditë para vdekjes. Kur ka ardhur nga puna një ditë janari 2008, ka qenë me probleme zemre, jam njoftuar për këtë dhe kam shkuar urgjent nga puna në shtëpinë e tij, më pas e kemi shtruar në spitalin e zemrës në QSUT “Nënë Tereza”, ku dhe vdiq. Pra, puna e tij mbeti përgjysmë, mallrat dhe dokumentet mbetën në dyqanin/garazhin e tij, dhe paratë cash gjithashtu. Im vëlla asokohe ndodhej në Kinë. Sikurse kam sqaruar më lart, im atë dhe im vëlla kanë qenë tregtarë, mendësia asokohe ishte që paraja duhej e disponueshme cash në dorë, sa më shpejt. Besimi te sistemi

⁴⁷ Pyetja nr. 6 e pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

bankar, sidomos pas krizës së firmave piramidale ishte zero, sepse askush nuk pati më besim te garancitë shtetërore pas humbjeve të pësuar. ...Sa u përket shumave që ai mund të ketë pasur nëpër duar gjatë tregtisë së tij nuk mund ta them me siguri të plotë. Pagesat për tatimet nuk ishin pjesë e bisedave me të, por mbaj mend që kur punonte në tregun te Fusha e Medresesë, pagesa në një periudhë ka qenë 300 lekë në ditë për stendën/vendin e tregimit, bënin pagesa tek inspektorët, sepse ndonjëherë më thoshte kur i vinin inspektorët. Po ashtu, nuk e di se si kanë qenë paguar detyrimet nga ai kur ka nisur të punonte si shitës ambulant dhe, më pas, në garazh, ngaqë ishte tashmë pensionist...”.

55.5. Gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, DPT-ja⁴⁸ ka bërë me dije se z. H. M. nuk rezultonte i regjistruar në Regjistrin Kombëtar, në organet tatimore.

55.6. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e përfituara nga babait i tij, të cilat pretendohet se kanë mundësuar krijimin e shumës prej 5.000.000 lekë, deklaruar si shumë e përfutur pasi babai ka ndërruar jetë, për të cilën i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit.

55.7. Pas njoftimit të rezultateve të hetimit, në parashtrimet e dërguara pranë Komisionit, subjekti ka referuar se, nga viti 1979 deri në ditën e vdekjes së të atit, ai dhe vëllai i tij nuk kishin jetuar me babanë e tyre. Për rrjedhojë, babai nuk ka qenë i lidhur me të as në kuptim të ligjit si pjesëtar familjar, as në kuptim faktik, pasi ka jetuar më vete. Ndërsa, për të provuar shumën e parave të pretenduar si të dhuruara nga babai i tij në vitin 2008, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të datës 31.10.2023, lëshuar nga z. E. K., kushëri i parë i subjektit (djali i motrës së të ndjerit), në të cilën deklaruesi sqaron në detaje marrëdhënien familjare dhe fqinjësinë me të ndjerin, si dhe paraqet informacion mbi veprimtarinë e tij tregtare, momentin e ndarjes nga jeta dhe mënyrën e përfitimit të shumës prej 5.000.000 lekësh nga subjekti. Konkretisht në lidhje më shumë e gjetur në garazh, z. K. ka deklaruar se: “*Para se të prishej garazhi i P. (H.) ngaqë rruga {***} do të zgjerohej dhe do të prisheshin ndërtimet pa leje, Elio, unë dhe disa vetë të tjerë kemi nxjerrë tërë mallrat e tij që mbaheshin nëpër thasë dhe kuti kartoni të trashë, kemi gjetur dokumentet e tij dhe gjithë vlerat monetare që ai ia ka lënë Elios, si biri i tij që ishte pranishëm në çdo çast. Pas vdekjes së tij, mallin e pashitur e mori në ngarkim e veja e H., Z. M., të cilën Elio e ka ndihmuar ndër vite”.*

55.8. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një vërtetim nga Drejtoria e Tregjeve dhe Tregtisë Vendore pranë Bashkisë Tiranë (DTTV)⁴⁹, ku referohet se ky institucion nuk disponon të dhëna për periudhat para vitit 2010 për subjektet që ushtronin tregti ambulante. Në të njëjtën shkresë, saktësohet se tregu ku ushtronte aktivitet i ndjeri ishte nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë dhe jo të organeve të tjera shtetërore, si dhe që tregtarët ambulantë të asaj periudhe nuk kishin marrëdhënie me Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, përveç pagesës simbolike të taksës vendore.

56. Në ankim, subjekti ka ripërsëritur pretendimin e ngritur edhe pranë Komisionit, se babai nuk ka qenë i lidhur me të as në kuptim të ligjit si pjesëtar familjar, as në kuptim faktik, pasi ka jetuar më vete. Në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të përfituara nga babai, subjekti

⁴⁸ Shkresa e DPT-së, me nr. {***} prot., datë 28.09.2023.

⁴⁹ Vërtetimi nr. {***} prot., datë 07.11.2023.

ka referuar se i ndjeri kishte ushtruar aktivitet tregtar si ambulant, gjatë periudhës 1990 – 2008, në kushtet e një kontrolli të kufizuar shtetëror dhe pa ekzistencën e një detyrimi real për mbajtjen e faturave formale apo dokumentacionit të standardizuar tatimor në atë periudhë. Ai ka potencuar se ekzistenca e vendimit gjyqësor për regjistrimin e aktivitetit si person fizik në vitin 2002, së bashku me mbi 330 fatura të paraqitura me përmbajtje të ngjashme, mandatet, fletëhyrjet/fletëdaljet, si dhe deklarata noteriale e lëshuar nga z. E. K. vërtetojnë natyrën dhe vijimësinë e aktivitetit tregtar të të ndjerit. Subjekti ka pretenduar se këto prova janë vlerësuar në mënyrë të padrejtë dhe të pamjaftueshme nga Komisioni, i cili ka mbështetur përfundimet e tij kryesisht në një përgjigje të DPT-së, duke i dhënë kësaj të fundit vlerë provuese në kundërshtim me tërësinë e provave të administruara në dosje, ndërkohë që ky institucion nuk përbën autoritetin kompetent për evidentimin dhe administrimin e të dhënave lidhur me aktivitetin e tregtarëve ambulantë në periudhën objekt shqyrtimi.

56.1. Subjekti i rivlerësimit, në ankim ka referuar ndër të tjera se: *“Në kohën e deklarimit të pasurisë sipas deklaratës vetting, unë nuk e kam deklaruar këtë sasi parash cash që kisha marrë nga ime atë pas vdekjes; ajo ishte deklaruar në deklaratën e pasurisë për vitin 2008, dhe në vijim pas dy vjetësh ishte treguar një vlerë më e ulët. Kjo shumë nuk është deklaruar më pas në vitet vijuese, as në deklaratën e vitit 2016, as në deklaratën vetting, datë 30.01.2017. Në atë deklaratë, unë dhe ime shoqe kemi deklaruar një sasi parash cash secili, me burim të qartë dhe të provuar dhe nga hetimi administrativ. Kjo sasi nuk buronte nga sasia 5,000,000 lekë që pata deklaruar për vitin 2008 dhe as për mbetjen e saj që kisha deklaruar dy vjet më vonë”.*

56.2. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shuma prej 5.000.000 lekësh, është e arsyeshme dhe në përputhje me nivelin e të ardhurave që mund të gjeneroheshin nga një aktivitet tregtar ambulant gjatë një periudhe afërsisht 17–18-vjeçare, ndonëse në kushte informale të tregut të asaj periudhe, ku përdorimi i mjeteve monetare në formë *cash* ishte praktikë e zakonshme dhe e përhapur.

56.3. Në parashtrimet e paraqitur në Kolegj, subjekti ka bashkëlidhur përgjigjet e kërkesave për informacion, të datës 28.07.2025, drejtuar bankave, nga shqyrtimi i së cilave trupi gjykues konstatoi se i ndjeri H. M. ka pasur llogari bankare vetëm pranë BKT-së. Referuar ekstraktit të kësaj llogarie bankare rezultoi se, gjatë periudhës 21.04.1997 – 12.09.1998, në këtë llogari evidentohen disa depozitime në momente të ndryshme, në shumën totale 1.150.000 lekë, të cilat janë investuar në depozita me afat dhe më pas janë tërhequr *cash* në datat 15.07.1999 dhe 21.09.1999. Gjithashtu, u konstatua se në datën 27.09.2002, ai ka përfituar një shumë prej 537.125 lekësh, burimi i së cilës nuk është i mundur të verifikohet nga ekstrakti. Rezulton se kjo shumë është investuar në depozitë bankare dhe ka gjeneruar interesa deri më datë 26.07.2005, në shumën totale prej 668.876 lekësh, e cila është tërhequr *cash* nga H. M.

57. Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, si dhe të atij të paraqitur nga subjekti pas njoftimit të rezultateve të hetimit si dhe me parashtrimet e dërguara në Kolegj, në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të tij lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të pretenduara si të përfituara nga babai, konstatoi sa vijon.

58. Trupi gjykues mori fillimisht në analizë pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se Komisioni nuk duhet ta kishte klasifikuar babain e tij si person të lidhur. Në këtë optikë, trupi gjykues, pa dashur ti rikthehet interpretimit të zgjeruar lidhur me konceptet “person i lidhur” dhe “person

tjetër i lidhur”, të elaboruara gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit, vëren se në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, klasifikimi i babait të subjektit si person tjetër i lidhur nga Komisioni, është bërë në këndvështrim të detyrimit të subjektit për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave prej 5.000.000 lekësh, të pretenduara si të dhuruara nga babai i tij, pra në kushtet e një lidhje reale financiare, në përputhje edhe me praktikën e konsoliduar tashmë të Kolegjit⁵⁰. Një pjesë e këtyre të ardhurave që pretendohet⁵¹ të jenë përdorur nga subjekti në vitin 2010, si një ndër burimet për likuidimin e kështit të dytë të apartamentit objekt shqyrtimi. Rrjedhimisht, shtrirja e kontrollit ndaj babai të tij, është e domosdoshme për të verifikuar burimin e ligjshëm të kësaj shume. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit, pasi cilësimi i babait të tij si person tjetër i lidhur nga Komisioni, është bërë në funksion të verifikimit të ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara nga subjekti në deklaratën *vetting*, si burim për krijimin e pasurive.

59. Trupi gjykues çmon të analizojë natyrën juridike të përfitimit të shumës prej 5.000.000 lekësh, nga subjekti, të deklaruar prej tij në DIPP-në e vitit 2008, si *“trashëgimi, dhurim nga babai, përfitur pak para vdekjes dhe përfitimi pas vdekjes”* dhe, në DIPP-në e vitit 2009, si *“trashëgimi pas vdekjes”*, në drejtim të vlerësimit, së pari, të ekzistencës reale e më tej të ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj. Në këtë optikë, trupi gjykues vlerëson se, nëse subjekti do ta kishte përfitur këtë shumë me trashëgimi pasi i ndjeri H. M. ka ndërruar jetë, në mungesë të një testamenti apo akti heqjeje dorë nga trashëgimia nga trashëgimtarët e tjerë, *prima facie* do të duhej që pasuria trashëgimore të ndahej sipas pjesëve takuese ligjore. Për rrjedhojë, subjekti do të duhej të provonte me dokumentacion ligjor se mbi çfarë baze ka përfitur të gjithë shumën prej 5.000.000 lekësh dhe jo vetëm pjesën takuese ligjore prej 1/3, për aq kohë sa rezulton se trashëgimlënësit i kanë mbijetuar, edhe bashkëshortja dhe djali tjetër. Ndërsa, nëse shuma është dhuruar nga i ndjeri gjatë kohës që ai ishte gjallë, atëherë kemi të bëjmë me dhurim *inter vivos* nga babai para vdekjes, lidhur me të cilin subjekti duhet të provonte ekzistencën e vullnetit të dhuruesit, momentin e dorëzimit të shumës dhe posedimin real të saj. Trupi gjykues vëren se edhe në këtë aspekt, vetë subjekti ka deklaruar se e ka *“të vështirë të provojë me dokumente ligjore dhurimin”*, çka e vështirëson edhe më tepër, besueshmërinë e përfitimit të këtyre të ardhurave, në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në këto kushte, çështja kryesore juridike mbetet jo ekzistenca historike e shumës, por ligjshmëria e burimit të saj, sikurse analizohet në vijim.
60. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të pretendimeve të tij mbi mënyrën e përfitimit të shumës, në analizë ka paraqitur një deklaratë noteriale në të cilën një i afërm i tij (z. E. K.) ka dhënë shpjegime lidhur me marrëdhënien e subjektit me babain, konkretisht përkujdesjen më të madhe të treguar prej tij krahasuar me vëllain tjetër, si dhe mbi rrethanat e gjetjes së shumës monetare (në një kuti në garazh pas vdekjes së të ndjerit). Trupi gjykues vëren se ky dokument krijon një kontekst shpjegues mbi marrëdhëniet familjare, jep shpjegime mbi mënyrën e posedimit faktik

⁵⁰ Shih, ndër të tjera, vendimet e Kolegjit, nr. 31/2019 (JR) dhe nr. 22/2022 (JR).

⁵¹ Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për likuidimin e çmimit të apartamentit, tri depozitat e analizuara më sipër, pa specifikuar fillimisht burimin e krijimit të tyre. I pyetur nga Komisioni lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer për furnizimin e këtyre depozitave, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se nuk e kujtonte këtë pagesë, ndonëse nuk e kundërshtonte, dhe se, nisur nga periudha e largët kohore, këto shuma mund të kenë buruar nga gjendje cash e krijuar nga trashëgimia e përfitur nga babai i tij, H. M., ose nga kursime familjare, pa qenë në gjendje të shprehej me siguri të plotë mbi burimin konkret të tyre.

të shumës dhe është në një masë të caktuar në përputhje me deklaratimet e hershme të subjektit, të bëra që në vitin 2008. Megjithatë, fakti që subjekti është përkujdesur më shumë ndaj babait të tij, në vetvete nuk përbën titull juridik për fitimin ekskluziv të një pasurie trashëgimore, në mungesë të testamentit, dhurimit të provuar, apo heqjes dorë nga trashëgimia nga trashëgimtarët e tjerë. Po kështu, rrethana faktike e prezantuar në deklaratë, se shuma prej 5.000.000 lekësh është gjetur në një kuti në garazh, nuk provon automatikisht origjinën e ligjshme apo destinimin e saj vetëm në favor të subjektit. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se deklarata noteriale e paraqitur nga subjekti, e cila synon të justifikojë se përse ai ka përfituar shumën e plotë prej 5.000.000 lekësh, pavarësisht ekzistencës së trashëgimtarëve të tjerë ligjorë, përbën një provë me natyrë deklarative, e cila bazuar në pikën 4 të nenit 49, të ligjit nr. 84/2014, si dhe qëndrimet në jurisprudencën e Kolegjit, ka efekt të kufizuar provues, dhe e vetme nuk mund të justifikojë ligjërisht ekzistencën e një pasurie, pronësinë mbi të, apo kalimin e ligjshëm të saj te subjekti.

61. Gjithashtu, trupi gjykues shqyrtoi edhe pretendimin e subjektit lidhur me burimin e të ardhurave të dhuruara nga babai i tij, në këndvështrim të kuadrit ligjor që normonte veprimtarinë e biznesit të vogël, përpara vitit 2008, kur pretendohet të jenë gjeneruar këto të ardhura përmes aktivitetit tregtar të të ndjerit H. M.
62. Në analizë të akteve në fashikujt e Komisionit, rezultoi se në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni, subjekti ka deklaruar se deri në vitin 2002 (për periudhën 1990 – 2002), babai i tij ka ushtruar aktivitetin në tregun pranë Medresesë pra, si ambulancë pa një vendndodhje fikse, dhe ka paguar taksat për stendë / vendin ku ushtronte aktivitetin, në vlerën 300 lekë në ditë, ndërsa për periudhën 2002 – 2008 ka ushtruar aktivitetin tregtar në njësi. Po ashtu, u konstatua se referuar Vendimit të Gjykatës me nr. {***}, datë 12.02.2002, për regjistrimin e z. H. M. si person fizik, babai i subjektit është regjistruar si person fizik në gjykatë me qëllim ushtrimin e aktivitetit tregtar. Nga ana tjetër, referuar shkresës së Qendrës Kombëtare të Biznesit⁵² dhe shkresës së DPT-së⁵³, z. H. M. nuk rezultonte i regjistruar as në regjistrin tregtar të QKB-së dhe as në organet tatimore. Po ashtu, Bashkia Tiranë, në përgjigjen e saj ka informuar Komisionin se nuk disponon të dhëna për shitësit ambulancë para vitit 2010, duke mos referuar asnjë të dhënë në lidhje me aktivitetin tregtar të ushtruar nga babai i subjektit.
63. Nisur nga fakti se veprimtaria e ushtuar ka qenë e kategorisë “ambulante”, trupi gjykues çmon t’i referohet kuadrit ligjor të kohës, që rregullonte veprimtarinë e biznesit të vogël. Në këtë optikë, trupi gjykues vëren se, në nenin 4 të ligjit nr. 7679, datë 03.03.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, përcaktohej se: *“Personat fizikë që ushtrojnë veprimtari ambulante e forma të tjera të kësaj natyre, paguajnë tatim vjetor me kuotë fikse, në këtë masë: a) tregtarët me pakicë të çdo lloji, 12.000 lekë në vit”*. Po ashtu, në nenin 5 të këtij ligji përcaktohet se: *“Tatimi vjetor sipas neneve 3 dhe 4, llogaritet dhe caktohet nga organet tatimore të komunave, bashkive e rretheve, brenda muajit janar për çdo vit tatimor, mbështetur në deklaratën vjetore parashikuese të bërë nga tatimpaguesi dhe verifikime të bëra nga punonjësit e organeve tatimore”*.

⁵² Me shkresën nr. {***} prot., datë 16.09.2020.

⁵³ Shkresa kthim përgjigje e DPT-së me nr. {***} prot., datë 28.09.2023, protokolluar në KPK me nr. {***} prot., datë 29.09.2023, pas kërkesës së bërë nga Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 14.09.2023.

64. Referuar ligjit nr. 8435, datë 28.12.1998, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, krahas taksave vendore, në periudhën që pretendohet se babai i subjektit ka ushtruar aktivitet tregtar, çdo biznes me xhiro vjetore deri në 8 milionë lekë dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar, ka qenë subjekt i tatimit mbi biznesin e vogël, sipas ligjit nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”⁵⁴, i ndryshuar⁵⁵, cili nënkupton tatimin me kuotë fikse, plus tatimin mbi xhiron. Konkretisht, aktiviteti në fjalë përfshihet në grupin E, “Ambulant, artizanat”, nëngrupi 1, “Tregtim e shërbim ambulator”, të nenit 3, pika 1, Kreu II, “Tatimi me kuotë fikse”, të këtij ligji. Në nenin 4 të këtij ligji, përcaktohet se: “1. Çdo person që kërkon të fillojë një biznes, duhet të regjistrohet në zyrën e tatimeve të rrethit ku ai ushtron veprimtarinë e tij. 2. Personi që regjistrohet, duhet të plotësojë deklaratën përkatëse me këto të dhëna ...”⁵⁶. Në këto kushte, lidhur me të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit për periudhën 1990 – 2001, referuar legjislationit të kohës, babai i subjektit ka pasur detyrimin për tu regjistruar në organet tatimore. Lidhur me periudhën e ushtrimit të aktivitetit pas vitit 2002, trupi gjykues vëren se tatimi mbi biznesin e vogël, në kuptim të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, klasifikohet në kategorinë e tatimeve dhe taksave kombëtare⁵⁷ dhe organi përgjegjës për zbatimin dhe administrimin e tij është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj në rrethe⁵⁸, dhe jo zyrat tatimore të pushtetit vendor, të cilat administrojnë vetëm tatimet dhe taksat vendore⁵⁹. Po ashtu, bazuar në ligjin me nr. 8435, datë 28.12.1998, “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, babai i subjektit krahas detyrimit për tu regjistruar në organet tatimore, ka pasur edhe detyrimin për pagesën e taksave sipas përcaktimeve në nenin 8⁶⁰ të ligjit nr. 8982, datë

⁵⁴ Në nenin 1 të këtij ligji përcaktohet se: “Subjekt i tatimit mbi biznesin e vogël është çdo person që kryen biznes në territorin e Republikës së Shqipërisë, gjatë çfarëdo periudhe të vitit kalendarik, i cili realizon një xhiro vjetore deri në 8 milionë lekë dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi vlerën e shtuar. Objekt i tatimit mbi biznesin e vogël është xhiroja (në lekë) e realizuar në çdo vend biznesi për një vit kalendarik. Tatimi mbi biznesin e vogël nënkupton tatimin me kuotë fikse, të llogaritur sipas tabelës përkatëse të Kreut II, plus tatimin mbi xhiron të llogaritur sipas dispozitave të Kreut III të këtij ligji. Në nenin 3 përcaktohet se: “Subjekte të tatimit me kuotë fikse janë ato subjekte që realizojnë një qarkullim deri në shumën 2.000.000 lekë në vit”. Në nenin 5 përcaktohet se: “Tatimi mbi xhiron është 4 për qind e xhiros për tatimpaguesit që realizojnë shumën nga 2 deri në 8 milionë lekë për çdo vit kalendarik”.

⁵⁵ I ndryshuar me ligjin nr. 8715, datë 15.12.2000, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8313, datë 26.03.1998, ‘Për tatimin mbi biznesin e vogël’”.

⁵⁶ Sipas përcaktimeve në këtë nen.

⁵⁷ Në nenin 6 të këtij ligji përcaktohet se: “2. Në tatimet dhe në taksat kombëtare përfshihen: a) tatimi mbi vlerën e shtuar; b) tatimi mbi të ardhurat; c) akcizat; ç) tatimi mbi taksa vendore për biznesin e vogël; [...]”.

⁵⁸ Në nenin 16, pika 1 e këtij ligji përcaktohet se: “[...] Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe degët e saj në rrethe janë organet kompetente që zbatojnë dhe administrojnë tatimet. Ajo e ka selinë në Tiranë. [...] Më tej, në nenin 18 përcaktohet se: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka degët e veta në rrethe. [...] Degët e tatimeve pajisin tatimpaguesit me certifikatë tatimore, hartojnë projekt programin e të ardhurave tatimore për rrethin, ndjekin dhe përgjigjen për realizimin e programit të të ardhurave tatimore, përpunojnë deklaratat tatimore, përcaktojnë dhe nxjerrin detyrimin tatimor, bëjnë ruajtjen dhe organizimin e dokumentacionit, kryejnë kontrollin e tatimpaguesve dhe mbledhjen e tatimeve, si dhe zbatojnë vendimet e veçanta ekzekutive”.

⁵⁹ Në nenin 22 të këtij ligji përcaktohet se: Tatimet dhe taksat vendore administrohen nga organet e qeverisjes vendore, të cilat kanë në varësi zyrat tatimore të pushtetit vendor. [...].

⁶⁰ Në këtë nen përcaktohet se: Në taksat vendore përfshihen: a) taksa vendore mbi biznesin e vogël, e cila rregullohet me ligj të veçantë; b) taksa mbi pasuritë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore; c) taksa e fjetjes në hotel; ç) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; d) taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme; dh) taksa e regjistrimit të përvitshëm të

12.12.2002, “Për sistemin e taksave vendore”. Përpos këtyre taksave vendore, të quajtura ndryshe si taksa të bashkisë dhe të komunës, në këtë periudhë, çdo person që ushtronte veprimtari biznesi, ka pasur edhe detyrimin e pagimit të taksës vendore të biznesit të vogël⁶¹ me kuotë fikse vjetore, ndër të cilët, edhe ambulantët në fushën e tregtisë dhe shërbimeve⁶², si dhe regjistrimin e çdo vendndodhjeje të biznesit në organin tatimor përgjegjës, sipas ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”⁶³, përpara nisjes së tij. Ndonëse sipas këtyre ligjeve, kjo lloj takse u klasifikua në kategorinë e taksave vendore, ajo gjeti rregullim me ligj të veçantë, konkretisht me ligjin nr. 8978, datë 12.12.2002, “Për taksën vendore për biznesin e vogël”, i cili parashikoi shprehimisht që kjo lloj takse do të vazhdonte të mbledhej nga administrata qendrore e tatimeve, sipas nenit 4 dhe 15 të këtij ligji⁶⁴. Vetëm më hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, u parashikua që organet kompetente për regjistrimin, deklarimin dhe pagesën e këtij detyrimi, do të ishin organet e pushtetit vendor.⁶⁵

65. Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se babai i subjektit ka pasur detyrimin ligjor për tu regjistruar në organet tatimore si dhe detyrimin për pagesën e taksave përkatëse sipas përcaktimeve ligjore të përshkruara më sipër, gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të aktivitetit nga ana e tij.
66. Duke iu rikthyer analizës së burimit të ligjshëm të krijimit të shumës prej 5.000.000 lekësh, trupi gjykues vlerëson se, në kuadër të procesit të rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ka pasur detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhuruar nga babai, të deklaruar nga subjekti me burim nga aktiviteti privat i babait. Ky vlerësim vjen pasi, referuar kuadrit ligjor të sipërcituar, nga viti 1993 deri në vitin 2006, detyrimi për regjistrimin e aktivitetit privat/biznesit i përkiste qartazi personit që dëshironte të ushtronte këtë aktivitet. Në zbatim të këtij kuadri ligjor, trupi gjykues vlerëson se, fakti që nga organet tatimore nuk konfirmohet regjistrimi i aktivitetit privat i të ndjerit H. M., për këtë periudhë, përbën provë të mosushtrimit të veprimtarisë së pretenduar në përputhje me ligjin dhe, për rrjedhojë, çdo e ardhur e krijuar në kuadër të një aktiviteti të tillë (pra, jo prej një burimi të ligjshëm), me të drejtë është vlerësuar nga ana e Komisionit se nuk përmbush standardin e të ardhurave të ligjshme, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

mjeteve; e) taksa për zënie e hapësirave publike; ë) taksa e tabelës dhe f) taksa të përkohshme.

⁶¹ Në këtë nen përcaktohet se: Në taksat vendore përfshihen: a) taksa vendore mbi biznesin e vogël, e cila rregullohet me ligj të veçantë; b) taksa mbi pasuritë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore; c) taksa e fjetjes në hotel; ç) taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja; d) taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme; dh) taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve; e) taksa për zënie e hapësirave publike; ë) taksa e tabelës dhe f) taksa të përkohshme.

⁶² Në tabelën nr. 1 të ligjit, shkronja Dh përfshihen “Ambulantët në fushën e tregtisë dhe të shërbimeve”.

⁶³ Ky ligj shfuqizoi ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, i ndryshuar.

⁶⁴ Në nenin 4 të këtij ligji përcaktohet se: Për dy vitet e para nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, organet tatimore janë degët e tatimeve, me përjashtim të rasteve kur organi tatimor caktohet nga Këshilli i Ministrave, mbështetur në rekomandimin e ministrit të Financave, në përputhje me kërkesën e organeve të pushtetit vendor. Më tej, në nenin 15, pika 2, përcaktohet se: “2. Për të gjitha çështjet për të cilat subjektet apelojnë, procedurat e apelit janë sipas ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999, ‘Për procedurat tatimore’, me ndryshimet përkatëse, për aq kohë sa kjo taksë vazhdon të mbledhet nga administrata qendrore e tatimeve, sipas nenit 4 të këtij ligji”.

⁶⁵ Në nenin 12, pika 1 e këtij ligji, përcaktohet se: “1. Taksapaguesi regjstron çdo vendndodhje të biznesit pranë bashkisë ose komunës përkatëse”.

67. Konkluzionet e mësipërme të trupit gjykues e bëjnë të pambështetur edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se mosregjistrimi në organin tatimor është i karakterit formal, sa kohë nuk rezultoi e provuar pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti privat i babait në periudhën 1993 – 2008 dhe, për rrjedhojë, ligjshmëria e burimit dhe të ardhurave, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
68. Gjithashtu, trupi gjykues konstatoi se dokumentacioni bankar i paraqitur nga subjekti, provon kryerjen e disa veprimeve bankare dhe disponimin e shumave monetare nga i ndjeri H. M. në periudha të caktuara, por nuk është i mjaftueshëm për të provuar ushtrimin efektiv të një aktiviteti tregtar që të ketë gjeneruar shumën e pretenduar prej 5.000.000 lekësh.
69. Lidhur me faturat, fletëhyrjet dhe blloqet me shënime të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues konstatoi se këto dokumente nuk përmbajnë elementët formalë dhe ligjorë të nevojshëm për t'u konsideruar dokumentacion provues me vlerë të plotë juridike, pasi nuk rezultojnë të pajisura me vulë, numër serial apo të jenë të konfirmuara nga organet tatimore kompetente. Në këto kushte, në përputhje me standardet e provueshmërisë të konsoliduara në jurisprudencën e Kolegjit, këto akte nuk mund të konsiderohen dokumente ligjore të mjaftueshme për të provuar ekzistencën dhe ligjshmërinë e të ardhurave të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit.
70. Për sa i përket themelit të pretendimit, e konkretisht përlllogaritjes së një vlere të ardhurash që sipas subjektit prindërit e dispononin në sajë të aktivitetit tregtar të babait, trupi gjykues, referuar qëndrimin të mbajtur nga Kolegji në raste të ngjashme⁶⁶, vëren se vlera e pretenduar nga subjekti është thjesht deklarative, pasi ndonëse i është kërkuar vazhdimisht nga Komisioni, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar të ardhurat e realizuara nga babai i tij.
71. Në analizë të gjithë sa më sipër, trupi gjykues, në një analizë garantiste, vlerësoi se edhe nëse do të konsiderohej e mirëqenë ekzistenca e të ardhurave të të ndjerit H. M., të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht mungesës së dokumentacionit ligjor që i përlligj ato, këto të ardhura do të dështonin të kalonin testin e ligjshmërisë, përcaktuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për këtë arsye, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme.
72. Në përfundim, të gjitha aspektet e rrethanave faktike, të cilat iu nënshtruan analizës ligjore, sjellin si konkluzion konstatimin e pamjaftueshmërisë dhe të paligjshmërisë së burimeve financiare të subjektit të rivlerësimit, nën dritën e nenit 32, pika 4, për sa i takon shumës 5.000.000 lekë, e cila ka shërbyer si burim krijimi për pagesën nga subjekti i rivlerësimit të këstit të dytë të pasurisë “apartament banimi” me sipërfaqe 129 m², në Tiranë.

⁶⁶ Në vendimin nr. 29/2024 (JR), datë 27.06.2024, që i përket subjektit Ndriçim Troplini, Kolegji ka arsyetuar se: Në kuadër të analizimit të pretendimit të subjektit se si burim krijimi të pasurisë apartament me sipërfaqe 77 m², në emër të nënës së tij, kanë shërbyer të ardhurat nga aktiviteti privat i prindërve të tij, trupi gjykues konstaton se, me shkresën nr. {***} prot., datë 23.02.2023, Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës ka informuar Komisionin se: “Nga kërkimi i të dhënave në sistemin tatimor c@ts për kërkim sipas personave/tatimpaguesve të lidhur rezulton se shtetasit H. T. dhe M. T., nuk figurojnë si tatimpagues në DRT-në Durrës”. Gjithashtu, të njëjtin konfirmim ka dhënë edhe Drejtoria e Hetimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. {***} prot., datë 11.03.2021. 26.19/a. Për rrjedhojë, në kushtet kur nuk vërtetohen me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti privat, në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për moskonsiderimin e tyre në analizën financiare si burim krijimi për apartamentin me sipërfaqe 77 m² në pronësi të nënës.

73. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, për të konsideruar si burim jo të ligjshëm për financimin e pagesës së fundit të pasurisë “apartament banimi”, në vitin 2010, diferencën e mbetur nga tërheqja e depozitave bankare, si e tillë, ajo nuk mund të përfshihet në burimet e ligjshme në analizën financiare për krijimin e kësaj pasurie.
74. Në shqyrtim të pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit në ankim, se Komisioni duhet të kishte analizuar mundësinë e kursimit të prindërve ndër vite, trupi gjykues konstaton se kursimet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit nuk mund të përlllogariten mbi përfitime joreale të prindërve të tij për periudhën e pretenduar (në mungesë të dokumentacionit provues), pasi do të prodhonin një rezultat të deformuar për efekt të procesit të rivlerësimit. Megjithatë, për një vlerësim më garantist lidhur me mundësinë e kursimit të babait të subjektit, në kuadër të një përlllogaritje të përafërt të kësaj mundësie me të ardhura nga pensionet si i vetmi burim, në kushtet e mos paraqitjes të dokumentacionit nga subjekti, trupi gjykues çmoi t’i referohej të dhënave statistikore të INSTAT⁶⁷, për të ardhurat mesatare nga pensionet në zonat urbane (duke marrë të mirëqenë se babai i subjektit ka dalë në pension në moshën 65 vjeç, pra në vitin 1995⁶⁸), si dhe duke qenë se përpara vitit 2000, nuk disponohen të dhëna statistikore mbi nivelin e pensioneve, duke marrë parasysh se pensionet në vitet në vijim kanë ndjekur një trend rritës, është e logjikshme të supozohet se në periudhën para vitit 2000, ato kanë qenë edhe më të ulëta. Referuar mesatares së të ardhurave pas vitit 2000, mund të konkludohet se në vitet pararendëse babai i subjektit nuk ka pasur mundësi kursimi nga të ardhurat nga pensionet, pasi këto të ardhura kanë qenë të ulëta në raport me shpenzimet e jetesës. Po ashtu, për periudhën 2000 – 2007, masa mesatare e pensioneve në qytet, e përlllogaritur në rastin konkret për dy persona, rezulton në shumën 1.424.592 lekë. Ndërkohë, për të njëjtën periudhë, shpenzimet e jetesës për dy persona janë vlerësuar në shumën 1.781.444 lekë. Sikurse vërehet, të ardhurat e përfituara nga pensionet nuk arrinin të mbulonin shpenzimet jetike, e për rrjedhojë mundësia e kursimit ka qenë në kufijtë e të pamundurës, ndërkohë që përjashtohet tërësisht mundësia që deri në fillim të vitit 2008, të mund të ishin realizuar kursimet në shumën 5.000.000 lekë.
75. Në përfundim të sa u analizua më sipër, lidhur me shumën 5.000.000 lekë, të deklaruar si të dhuruar nga babai, H. M., trupi gjykues vlerëson se, edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk është i besueshëm për përfitimin e kësaj shume prej të atit të tij, ai nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor, burimet financiare të ligjshme të të atit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, si dhe të ardhurën faktike të realizuar në një masë të tillë që të justifikonin shumën e deklaruar si të dhuruar në deklaratën e interesave private/periodike vjetore, të vitit 2008 dhe atë *vetting*. Për më tepër, trupi gjykues vlerësoi se të ardhurat e pretenduara nuk plotësonin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si të ardhura të ligjshme. Për rrjedhojë, sikurse ka konkluduar dhe Komisioni, shuma e pretenduar nga subjekti si e dhuruar nga babai i tij, nuk u përfshi në analizën financiare të periudhës 2008 – 2016, dhe as si burim për krijimin e pasurisë “apartament banimi” në rrugën “{***}”, Tiranë.

⁶⁷ https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_SS/SS0008/table/tableViewLayout1/

⁶⁸ Referuar vitit 1930, kur ka lindur babai i subjektit.

d) Në lidhje me gjendjen cash të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar vetting

76. Komisioni, në lidhje me deklaratimet *cash* ndër vite, të subjektit të rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: *“Në shqyrtimin përfundimtar të deklaratimeve të bëra nga subjekti mbi shtesat/pakësimet dhe gjendjet e likuiditeteve cash ndër vite, Komisioni vlerëson se ai ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, duke u vendosur në kushtet e parashikuara sipas leximit a contrario të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016”*.
77. Në ankim, subjekti ka pretenduar se, lidhur me gjendjen *cash*, me burim nga të ardhurat e babait, e përfutuar në vitin 2008, Komisioni duhet të kishte mbajtur në konsideratë deklaramin e tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, në të cilën kjo shumë nuk është përfshirë për shkak se nuk ekzistonte më në momentin e plotësimit të kësaj deklarate. Po ashtu, sipas subjektit, hetimi për pasurinë *cash* nga Komisioni është i paligjshëm dhe në kundërshtim me qëndrimin e konsoliduar të jurisprudencës së Kolegjit⁶⁹.

77.1. Nga shqyrtimi i deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, sa i takon gjendjes *cash*, rezultoi sa vijon:

- Në deklaratën *vetting*⁷⁰, subjekti ka deklaruar: *“Të holla (cash), në shumën 5.000.000 lekë, të përfutuara pas vdekjes së H. M., më 18.02.2008. Nuk kam dokumente provuese. Janë deklaruar si shumë në deklaramin periodik, kam dhënë shpjegime dhe kam paraqitur dokumente të veprimtarisë tregtare të të ndjerit në vitin 2016, gjatë kontrollit tërësor të pasurisë së kryer nga ILDKPKI”*. Gjendje *cash*, 35.000 lekë. Ndërsa personi i lidhur ka deklaruar 23.000 lekë dhe 3.000 euro.
- Në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë (në vijim “DIPP”) e vitit 2004, subjekti ka deklaruar 400.000 lekë kursime *cash*.
- Në DIPP-në e vitit 2006, ka deklaruar pakësimin e shumës 400.000 lekë, e cila është depozituar në bankë dhe 100.000 ose 200.000 lekë të dhëna nga babai ose vëllai (Komisioni ka konsideruar 150.000 lekë).
- Në DIPP-në e vitit 2008,⁷¹ subjekti ka deklaruar: *“Të holla (cash) të përfutuara pas vdekjes së babait më 18.02.2008, në shumën 5.000.000 lekë, pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: trashëgimia, dhurimi nga babai pak para vdekjes dhe përfitimi pas vdekjes”*.
- Në DIPP-në e vitit 2009⁷², subjekti ka deklaruar: *“Të holla (cash) të trashëguara nga im atë pas vdekjes, janë pakësuar gjatë vitit 2009”*. Shuma 2.000.000 lekë. Pjesa takuese 100%
- Në DIPP-në e vitit 2016: (i) subjekti ka deklaruar lekë në dorë (*cash*) në fund të vitit, tërhequr nga llogaria e pagës në shumën 10.000 lekë; (ii) personi i lidhur ka deklaruar para në dorë *cash* 20.000 lekë dhe 6.000 euro, me burim tërheqje nga llogaria bankare në Raiffeisen Bank.

⁶⁹ Në ankim, subjekti ka përmendur një sërë vendimesh të Kolegjit për këtë pretendim, konkretisht vendimet: nr. 11, datë 02.05.2019, nr. 12, datë 17.12.2019, nr. 13, datë 20.06.2019; nr. 7, datë 24.06.2020; nr. 8, 25.06.2020; nr. 34, 02.12.2019; nr. 10, datë 08.09.2020; dhe nr. 21, datë 10.09.2020.

⁷⁰ Në seksionin “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”.

⁷¹ Në seksionin “Ndryshimet e interesave private, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”.

⁷² Në seksionin “Ndryshimet e interesave private, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”.

77.2. Në procesverbalet e mbajtura nga ILDKPKI-ja në datat 2 dhe 27 qershor të vitit 2016, i pyetur për gjendjen e likuiditetit *cash* më datë 31.12.2014 subjekti ka deklaruar: “*Vlera minimale. Likuiditetin e kam në sistemin bankar*”. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, lidhur me shtimin/pakësimin, gjendjen dhe burimin e krijimit të mjeteve monetare jashtë sistemit bankar, për periudhën 2003 – 2016 dhe në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se nuk kujton vlera të sakta për çdo vit kalendarik, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, dhe se mund të ketë pasur kursime *cash* në vite të ndryshme, të krijuara nga: (i) të ardhurat personale nga punësimi i tij para dhe pas emërimit në organin e prokurorisë; (ii) të ardhurat e bashkëshortes, znj. V. M., para dhe pas martesës; (iii) ndihma e ofruar nga i vëllai, rezident jashtë vendit; (iv) trashëgimia nga i ati në vitin 2008, në shumën prej 5.000.000 lekësh, e deklaruar zyrtarisht dhe e përdorur për qëllime jetese familjare në vitet në vijim. Po ashtu, në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: (i) gjendja e deklaruar *cash* prej 3.000 eurosh, lidhet me tërheqjen e mëparshme prej 6.000 eurosh nga llogaria rrjedhëse e bashkëshortes në Raiffeisen Bank ShA, me burim të ardhurat nga kontrata me shoqërinë “{***}”, të deklaruara për vitin 2016; (ii) më datë 18.01.2017, është mbyllur një depozitë në Credins Bank ShA në emër të dy bashkëshortëve dhe shuma përkatëse 7.618,41 euro është depozituar një ditë më pas në një llogari kursimi në BKT; (iii) nga kjo shumë, rreth 3.000 euro janë mbajtur në formë *cash* dhe janë deklaruar në deklaratën *vetting* dorëzuar më 30.01.2017 dhe 3.000 euro të tjera janë shtuar vlerës së depozituar në BKT.

78. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar⁷³ të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, u konstatua se në datën 18.01.2017, znj. V. M. ka tërhequr shumën 7.618,41 euro nga llogaria dyemërore me subjektin pranë Credins Bank. Po ashtu, rezultoi se në datën, 19.01.2017, në llogarinë e përbashkët të bashkëshortëve pranë BKT-së, është depozituar *cash* shuma 10.000 euro nga znj. V. M., nga e cila 9.985 euro janë investuar po atë ditë në një depozitë me afat njëvjeçar.
79. Në deklaratat periodike të pasurisë për periudhën 2003 – 2016, subjekti ka deklaruar një rritje progresive të kursimeve *cash* jashtë sistemit bankar, të cilat në vitin 2008 arrijnë në vlerën 5.150.000 lekë, përfshirë shumën prej 5.000.000 lekësh, pretenduar si e dhuruar nga babai. Në vitin 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash* me 2.000.000 lekë, duke mos dhënë shpjegime në deklaratat vijuese, lidhur me destinacionin e gjendjes *cash* të mbetur prej 3.000.000 lekësh. I pyetur nga Komisioni lidhur me këtë shumë, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: “[...] duhet të ketë vijuar dhe të jetë përdorur e shpenzuar dhe në vitet vijuese. Por, që të përcaktoj saktësisht vlerën për çdo vit pas kaq shumë vitesh, kjo do të ishte gënjeshtër. Nuk besoj që do e mbaja mend vlerën e saktë as për vitin pasardhës, e jo më tani”.
80. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, kanë deklaruar si gjendje *cash* shumën prej 58.000 lekësh. Ndërkohë që, sipas gjendjeve të deklaruara ndër vite likuiditetet *cash* arrijnë në shumën prej 3.180.000 lekësh në fund të vitit 2016.

⁷³ Shkresa e Bankës Kombëtare Tregtare ShA (BKT) nr. {***} prot., datë 11.09.2020; Shkresa e Credins Bank nr. {***}/2014.

81. Në analizë të situatës faktike, trupi gjykues çmon ti referohet përcaktimit në nenin 4/1⁷⁴ të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, sipas së cilit zyrtarët nuk mund të mbajnë dhe të deklarojnë gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar mbi shumën 1.5 milionë lekë. Në këtë optikë, trupi gjykues çmoi ta konsiderojë si të shpenzuar gjendjen *cash* prej 3.000.000 lekësh, deri në vitin 2014 (momenti kur ligji ka hyrë në fuqi), duke konkluduar se mosdeklarimi i pakësimit të kësaj shume nga subjekti i rivlerësimit, përbën pasaktësi, pa pasoja në kuadër të procesit të rivlerësimit, për sa kohë këto të ardhura nuk janë pretenduar të jenë përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie të subjektit të rivlerësimit, por vetëm për mbulimin e shpenzimeve të jetesës në vite.
82. Në përfundim, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, trupi gjykues vlerëson se lidhur me gjendjen e deklaruar *cash*, subjekti nuk gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë, sipas leximit a *contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Në lidhje me pretendimin e subjektit për analizimin e mundësisë së krijimit të gjendjes *cash*, duke mos përfshirë shumën 5.000.000 lekë, që nga viti 2008 deri në 30.01.2017 kur është dorëzuar deklarata *vetting*, trupi gjykues arriti në përfundimin se, për gjendjet *cash* të deklaruara në vitet 2004, 2006 dhe 2008, përkatësisht në shumat 400.000 lekë, 150.000 lekë dhe 5.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për secilin vit përkatësisht në shumat (-)620.074 lekë, (-)1.330.389 lekë dhe (-) 7.838.150 lekë. Edhe në rast se shuma prej 5.000.000 lekësh nuk do të konsiderohej si gjendje *cash* në vitin 2008, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur do të rezultonin sërish me mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën (-) 2.838.150 lekë.

e) Në lidhje me të ardhurat e personit të lidhur D. (M.) P., vëllai i subjektit

83. Komisioni ka arritur në përfundimin se: “Shumat e deklaruara si të dhuruara prej vëllait nuk mbulohen me burime financiare të ligjshme e, për rrjedhojë, ato nuk do të reflektohen në analizën financiare si të ardhura të mundshme për krijimin e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur”.
84. Subjekti ka pretenduar se vëllai i tij nuk duhet të konsiderohet person i lidhur vetëm për faktin se ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me të, pasi nuk kanë pasur bashkëjetesë faktike. Po ashtu, subjekti ka pretenduar se ndihma financiare e ofruar gjatë periudhës 1995 - 2018, nga vëllai, i cili ka jetuar dhe punuar në shtete si: Kanada, Japoni dhe Kinë, nuk e bën atë person të lidhur me subjektin e rivlerësimit.
85. Nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit, rezultoi sa vijon:
- Në deklaratën *vetting*⁷⁵, subjekti ka deklaruar: “Të ardhura nga im vëlla, të sjella ndër vite, pasi ishte në emigracion. Këto vlera kanë qenë sjellë edhe para se të nisja punën në prokurori edhe gjatë saj. Një herë paratë janë derdhur prej tij në shumën 4.500 euro në llogarinë nr. {***} në ISP Bank. Të tjera dokumente nuk disponoj. Gjithsej, mund të jenë në vlerën 22.000 (njëzet e dy mijë) euro”.

⁷⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 45/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003”.

⁷⁵ Në seksionin “Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre”.

- Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti ka deklaruar: “*Dhuratë në të holla, në euro, nga im vëlla ..., dhënë në dorë kur ka ardhur nga jashtë*. Shuma 5.000 euro.
 - Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar: “*Dhuratë familjes, në vlerën 4.500 euro, nga im vëlla, D. P., që jeton jashtë vendit. Shuma është derdhur në llogarinë me nr. {***}, në ISP Bank*.”
 - Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar: “*Dhuratë në të holla nga im vëlla, D. P. (M.)*”. Shuma 7.000 euro.
 - Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar: “*Dhuratë në të holla në muajin qershor 2013 - D. P. (M.), im vëlla*”. Shuma 5.000 euro.
 - Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar: “*Dhuratë në të holla. D. H. P.*”. Shuma 3.000 euro.
86. Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga vëllai i tij, nga aktiviteti tregtar ushtruar prej tij në Shqipëri, gjatë periudhës 1992 – 1995, si dhe nga punësimi i tij gjatë vitit 2002, subjekti ka paraqitur pranë Komisionit dokumentacionin si vijon:
- i) Vendim gjykate nr. {***}, datë 14.04.1994, për regjistrimin si person fizik me objekt “transport mallrash me shumicë dhe pakicë”;
 - ii) Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore për periudhën 01.01.1993 – 30.06.1993;
 - iii) Librezë pune që pasqyron ushtrimin e aktivitetit si person fizik nga 01.01.1991 deri më 30.06.1993;
 - iv) Pasaportë e D. P. me vizë kineze për periudhën 12.03.2008 – 12.06.2008;
 - v) Karta aksesi të lëshuara në emër dhe me fotografinë e D. P. nga *Top Channel* dhe “*Video Graphic Agency*”, pranë së cilave ka qenë i punësuar gjatë vitit 2002.
87. Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të dhuruara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon se analiza e burimeve financiare të tij është e domosdoshme në kuadër të procesit të rivlerësimit, për shkak të marrëdhënies financiare të drejtpërdrejtë me subjektin, detyrim që buron drejtpërdrejt nga dispozitat e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Konkretisht, neni 32 i këtij ligji parashikon se subjekti i rivlerësimit ka detyrimin për të provuar të kundërtën e barrës së provës së kaluar nga organi i rivlerësimit dhe duhet të paraqesë prova të plota e bindëse mbi ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura për krijimin e pasurive. Në këtë kuadër, fakti që vëllai i subjektit ka qenë pjesë e të njëjtës përbërje familjare gjatë periudhës së rivlerësimit merr rëndësi të posaçme juridike, pasi sipas nenit 3, pika 14, të ligjit nr. 84/2016, personat e lidhur dhe personat e tjerë të lidhur financiarisht me subjektin i nënshtrohen verifikimit në funksion të kontrollit të pasurisë.
88. Në këtë drejtim, nga aktet rezultoi se vëllai i subjektit ka qenë pjesë e së njëjtës përbërje familjare gjatë periudhës së rivlerësimit, çka e vendos atë në një raport ekonomik e financiar të ndërvarur me subjektin dhe justifikon verifikimin e të ardhurave të tij nga organet e rivlerësimit. Jurisprudenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelit ka mbajtur një qëndrim të konsoliduar se, në

rastet kur persona të afërt familjarë pretendohet se kanë kontribuar në krijimin e pasurive të subjektit, barra e provës mbi ligjshmërinë, ekzistencën dhe disponueshmërinë reale të këtyre të ardhurave i takon subjektit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, nuk mjafton deklarimi formal apo ekzistenca e një deklarate noteriale dhurimi, por kërkohet provueshmëri konkrete mbi burimin e ligjshëm të të ardhurave, aftësinë financiare të dhuruesit dhe mundësinë reale të kursimit të shumave të pretenduara.

89. Në këto kushte, në mungesë të dokumentacionit të plotë ligjor e financiar që provon krijimin e ligjshëm të të ardhurave të dhuruesit, këto të ardhura nuk mund të konsiderohen burime të ligjshme për justifikimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, trupi gjykues çmon se për t'i konsideruar si burim për krijimin e pasurive dhe përballimin e shpenzimeve të jetesës së subjektit dhe personit të lidhur, këto të ardhura duhet të vlerësohen paraprakisht në drejtim të provueshmërisë së ekzistencës faktike, si dhe ligjshmërisë së tyre. Në këtë këndvështrim, trupi gjykues vëren se:
90. *Së pari*, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me shumat e pretenduara si të dhuruara nga vëllai i tij, trupi gjykues konstaton se ka mospërputhje të shumës totale të deklaruar sipas deklaratave periodike (shumë totale e shpërndarë në vite, prej 24.500 eurosh) me shumën e deklaruar në deklaratën *vetting* (në të cilën subjekti ka deklaruar shumën totale prej 22.000 eurosh).
91. *Së dyti*, ndonëse ka indicie që dëshmojnë mbi faktin se vëllai i subjektit ka jetuar dhe punuar në periudha të ndryshme në Kanada, Kinë dhe Japoni⁷⁶, subjekti dështoi të provojë me dokumentacion justifikues ligjor, burimet e ligjshme, të ardhurat faktike si dhe ligjshmërinë e të ardhurave të përfituara nga vëllai i tij.
92. *Së treti*, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, në funksion të dokumentimit të të ardhurave të përfituara nga: (i) aktiviteti tregtar i ushtruar nga vëllai i tij gjatë periudhës 1992 – 1995, si dhe (ii) punësimi i tij, gjatë vitit 2002, pranë *Top Channel* dhe "*Video Graphic Agency*", trupi gjykues konstatoi se dokumentacioni i paraqitur, nuk provon as shumën e të ardhurave të realizuara dhe as ligjshmërinë e tyre (pra pagesën e detyrimeve tatimore lidhur me to). Po ashtu, përkundër nga sa pretendoi subjekti mbi mënyrën e administrimit të të ardhurave të dërguara nga vëllai i tij, e vetmja gjurmë apo lëvizje bankare që mbështet pretendimin e subjektit se vëllai i ka dërguar para përmes bankës, është depozita në shumën prej 4.500 eurosh, në datën 15.03.2011, e pasqyruar në ekstraktin bankar⁷⁷ të llogarisë së përbashkët të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij në ISP Bank, me përshkrimin "*Cash deposit, D. P.*". Sikurse evidentohet qartësisht nga koha e depozitimit, kjo shumë nuk mund të ketë shërbyer si burim për krijimin e depozitave të cilat janë krijuar gjatë periudhës 2002 – 2008.

⁷⁶ Gjatë hetimit të kryer nga Komisioni, subjekti ka paraqitur dokumente të tilla si: bileta avioni; vërtetim nga Bashkia Tiranë që nuk ka pengesë për lidhje martesë në Kanada; dëshmi penaliteti; kartë bankare; kontratë qiraje e datës 28.06.2016, për periudhën 01.08.2016 – 31.07.2022, nënshkruar nga shtetasi L. B.; fatura të vitit 2016 për blerje mallrash, përfshirë pagesë për konditioner dhe paradhënie; ekstrakt i llogarisë bankare e hapur në vitin 2017 në emër të D. P.; ekstrakt i llogarisë bankare të hapur në dhjetor 2016 në emër të tij; kontratë për shitje produktesh industriale, e datës 07.05.2016.

⁷⁷ Shkresa kthim përgjigje e ISP Bank, nr. {***} prot., datë 18.09.2020.

93. Për sa më sipër, lidhur me shumën 22.000 euro, të pretenduar si të dhuruar nga vëllai, D. (M.) P., trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor, burimet financiare të ligjshme të tij si dhe të ardhurën faktike të realizuar gjatë periudhës 1992 – 2016, në një masë të atillë që të justifikonin shumat e deklaruara si të dhuruara në deklaratat periodike vjetore dhe atë *vetting*. Për më tepër, trupi gjykues vlerësoi se ato nuk plotësonin kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si të ardhura të ligjshme. Për rrjedhojë, ashtu sikurse ka konkluduar dhe Komisioni, këto të ardhura nuk u përfshinë në kuadër të analizës së burimeve të krijimit të pasurisë apartament banimi e ndodhur në rrugën Xh. M., në Tiranë, si dhe analizën financiare të periudhës 2010 – 2014.
94. Lidhur me pretendimin e subjektit se, nëse Komisioni do të kishte përjashtuar nga analiza të ardhurat e pretenduara si të përfituara nga vëllai ndër vite, subjekti dhe familja e tij do të rezultonte me burime të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet dhe për të krijuar kursime, trupi gjykues konstaton se ky pretendim nuk qëndron pasi edhe pse këto të ardhura nuk janë përfshirë nga Komisioni në analizën financiare për periudhën 1995 – 2014, përsëri subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë rezultuar me balancë negative për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të tyre.
95. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën *vetting* të pasurisë nga vëllai, D. P., në cilësinë e personit të lidhur, trupi gjykues vëren se cilësimi i vëllait të subjektit të rivlerësimit, si person i lidhur nga Komisioni, është bërë në zbatim të përkufizimit në pikën 13 të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në faktin se gjatë periudhës së rivlerësimit, ky person / i afërm i familjes, ka qenë në të njëjtën përbërje familjare me subjektin, dhe sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe neneve 30 dhe 32, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, z. D. P. kishte detyrimin për deklarimin në deklaratën *vetting*, të pjesëve të tij takuese në pasuritë e paluajtshme të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, në të cilat ai figuron si bashkëpronar, si dhe justifikimin e burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të tij. Në kushtet kur nuk ka deklarime në deklaratën *vetting* lidhur me pasurinë e vëllait, z. D. P. dhe burimet e krijimit të saj, ndonëse është në të njëjtën përbërje certifikatë familjare, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
96. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshortja e tij, rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-)15.087.344 lekë, për krijimin e pasurisë së llojit apartament banimi, e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, më datë 30.06.2010, me vlerë 15.990.000 lekë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion u mbështet në analizën, vlerësimin dhe qëndrimet e trupit gjykues për burimet e krijimit të kësaj pasurie, të deklaruara e të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, lidhur me të cilat subjekti i rivlerësimit nuk provoi burimin e ligjshëm për shlyerjen e kështit të parë në shumën 112.000 euro (më datë 02.07.2005) dhe kështit të dytë në shumën 5.000 euro (më datë 05.02.2010), sikurse u analizua më sipër në këtë vendim.
97. Lidhur me analizën financiare për periudhën 1995 – 2003, si dhe për vitet 2004, 2005, 2006, 2007, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i

rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e pasurive, si dhe kryerjen /mbulimin e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara pasi kanë rezultuar me një balancë negative totale prej (-) 20.613.297 lekësh, duke konfirmuar balancat negative të përlllogaritura nga Komisioni, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

98. Trupi gjykues çmon të theksojë se edhe në versionin që të ardhurat e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit do të konsideroheshin sipas pretendimeve të tij në analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurisë “apartament banimi” në rrugën “{***}”, Tiranë, përsëri mungesa e burimeve financiare të ligjshme rezulton në vlerën (-) 4.488.343 lekë, për të cilën nuk mund të aplikohet zbatimi i parimit të proporcionalitetit. Nga ana tjetër, ndonëse i gjeti të drejta disa nga pretendimet e ngritura në ankim nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se ato janë të pamjaftueshme për të ndryshuar vendimin objekt shqyrtimi.
99. Në përfundim, në konsideratë të konkluzioneve të sipërcituara, nën dritën e përcaktimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas përcaktimit në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 717, datë 23.11.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 717, datë 23.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Elio Mazreku.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 20.11.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi